**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E EKOMOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

# SKELETKURRIKULI

## Për Kualifikimin Profesional

# MODELIM

**Niveli III i KSHK[1], referuar nivelit III në KEK[2]**

**(1 vjeçar)**

**Kodi: D3-III-25**

Miratoi:

MINISTRI

1.Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
2.Korniza Evropiane e Kualifikimeve

**Tiranë, 2025**

## Përmbajtja:


**I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional "Modelim", niveli III i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), 1 vjeçar.**

**II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional "Modelim", niveli III i KSHK.**

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në kualifikimin "Modelim", niveli III i KSHK.
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në kualifikimin "Modelim", niveli III i KSHK.
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në kualifikimin "Modelim", niveli III i KSHK.
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në kualifikimin "Modelim", niveli III i KSHK.

**III. Plani mësimor për kualifikimin profesional "Modelim", niveli III i KSHK.**

**IV. Udhëzime për planin mësimor.**

**V. Udhëzime për procesin mësimor.**

**VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

**VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional "Modelim", niveli III i KSHK.**

**VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**

**IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**

**X. Përshkruesit e moduleve me zgjedhje të detyruar të praktikës profesionale.**

**XI. Programi orientues për provimet përfundimtare të kualifikimit profesional "Modelim", Niveli III i KSHK.**

## I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional "Modelim", niveli III i KSHK.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në kualifikimin "Modelim", niveli III i KSHK, është *"zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t'u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me sektorin e modelimit të veshjeve*". Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t'u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t'i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t'u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t'u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

## II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional "Modelim", niveli III i KSHK

### 1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në kualifikimin "Modelim", niveli III i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në kualifikimin "Modelim" niveli III i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në kualifikimin "Tekstil-Konfeksione", niveli II i KSHK;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MEKI përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

### 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional "Modelim", niveli III i KSHK

Në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin "Modelim", niveli III i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.

- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efiçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integrimeve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuara.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

**3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional "Modelim", niveli III i KSHK.**

Në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin "Modelim", niveli III i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin II të KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:
- Të organizojë vendin e punës.
- Të përcaktojë ndikimin e konceptit të estetikës në realizimin e veshjeve.
- Të interpretojë ndikimin estetik të veshjeve popullore në realizimin e veshjeve.
- Të interpretojë skicën (vizatimin) nga stilisti.
- Të zbërthejë në detaje skicën teknike.
- Të shpërndajë punën tek stafi.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik.
- Të përdorë programe të mdryshme të CAD-it për dizenjimin dhe modelimin e veshjeve.
- Të përzgjedhë pëlhurën në varësi të modelit në skicë.
- Të përzgjedhë materialet ndihmëse dhe aksesorët e qepjes në varësi me modelin dhe skicën.
- Të përgatisë kallëpet e prerjes bazuar në modelin dhe skicën.
- Të presë materialin sipas modelit dhe skicës.
- Të ndjekë tërësinë e procesit të prodhimit.
- Të përzgjedhë metodën e montimit të qepjes, sipas modelit .
- Të realizojë ekonomizimin e lëndës së parë, nëpërmjet një llogaritjeje të thjeshtë.
- Të llogarisë kostot e veshjeve të modeluara.
- Të komunikojë saktë dhe në mënyrë profesionale me klientët, furnitorët dhe bashkëpunëtorët.
- Të zbatojë rregullat e ruajtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.
- Të mirëmbajë mjetet dhe pajisjet e punës.

**4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional "Modelim", niveli III i KSHK.**

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në kualifikimin “Modelim”, niveli III i KSHK, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës si modelist në reparte industriale dhe artizanale.
Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV të KSHK (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin “Tekstil konfeksione”, për të fituar diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

## III. Plani mësimor për arsimin profesional në kualifikikimin profesional “Modelim”, niveli III i KSHK

| Plani mësimor për kualifikimin profesional “Modelim”, niveli III i KSHK | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr** | **Kodi** | **Lëndët dhe modulet mësimore** | **Orët javore/ vjetore** |
| | | | **Klasa 12** |
| **A.** | | **Lëndët e përgjithshme** (Gjithsej) | **8/9** (272/306) |
| 1 | | Gjuhë shqipe | 1 |
| 2 | | Letërsi | 1 |
| 3 | | Gjuhë e huaj e parë | 2 |
| 4 | | Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë) | (1) |
| 5 | | Matematikë | 2 |
| 6 | | Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK) | 1 |
| 7 | | Edukim fizik, sporte, shëndet | 1 |
| **B.** | | **Lëndët profesionale** (Gjithsej) | **7** (238) |
| 1 | L-17-157-22 | Bazat e sipërmarrjes | 2 |
| 2 | L-33-731-25 | Moda dhe estetika | 2 |
| 3 | L-33-732-25 | Hyrje në programin CAD/CAM | 1 |
| 4 | L-33-733-25 | Modelimi i veshjeve | 2 |
| **C.** | | **Module të detyruar të praktikës profesionale** (Gjithsej) | **12** (408) |
| 1 | M-10-2155-25 | Planifikimi dhe organizimi i punës në modelim | 68 |
| 2 | M-33-2156-25 | Marrja e masave dhe përgatitja e kallëpeve | 34 |
| 3 | M-33-2157-25 | Realizimi i prototipit | 84 |
| 4 | M-33-2158-25 | Konfeksionimi i produktit | 120 |
| 5 | M-33-2159-25 | Kryerja e kontrollit të cilësisë, gjatë modelimit të veshjeve | 34 |
| 6 | M-38-2160-25 | Komunikimi dhe etika profesionale gjatë modelimit të veshjeve | 34 |
| 7 | M-05-2161-25 | Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit gjatë modelimit të veshjeve | 34 |

| D. | | **Module me zgjedhje të detyruar të praktikës profesionale** (Gjithsej) | **3** (102) |
|---|---|---|---|
| 1 | M-33-2162-25 | Realizimi dhe konfeksionimi i prototipit të veshjeve të brendshme | 102 |
| 2 | M-33-2163-25 | Zhvillimi i kallëpeve në masa të tjera | 51 |
| 3 | M-33-1688-20 | Projektimi modeleve të veshjeve me anë të CAD/CAM | 51 |
| 4 | M-17-2199-25 | Shoqëria e nxënësve | 51 |
| | | **Gjithsej A+B+C+D** | **30/31** (1020/ 1054) |

## IV.Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime)
Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).
Një orë mësimore zgjat 45 minuta.
Kurrikuli i arsimit profesional në kualifikimin profesional "Modelim", niveli III i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

## V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin te ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.
E rëndësishme është që ***planifikimi i mësimdhënies*** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integrimit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.
Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimii nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.
Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi

i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të kualifikimit profesional “Modelim”, niveli III i KSHK.
Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.
Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të kualifikimit profesional “Modelim”.
Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

## VI.Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.
Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në kualifikimin profesional “Modelim”, niveli III i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:
a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;
Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e modelimit, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit III të KSHK.

## VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Modelim”, niveli III i KSHK

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Modelim”, niveli III i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli, si dhe me Certifikatën e aftësimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MEKI, këto dëshmi përmbajnë:
a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
b) Të dhëna për rezulatet e arrritura nga nxënësi:
- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
- rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit III të KSHK.

## VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

### 1. Lënda "Bazat e sipërmarrjes" (L-17-157-22). Kl. 12 – 68 orë

- **Synimet e lëndës "Bazat e sipërmarrjes", kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Bazat e sipërmarrjes", kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontektin individual dhe shoqëror
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontektin e nismave sipërmarrëse
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhëshme
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to.
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup
- të analizojnë veçoritë e gadishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efiçiencë burimet e ndryshme si mjedisin, paratë, kohën etj.
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve
- të përshkruajnë marrëdhëniet e punës në një sipërmarrje.
- të përshkruajë hapat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve individuale dhe kolektive në mjedisin e punës.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Bazat e sipërmarrjes", kl.12 – 68 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes | 3 orë |
| **Tema 2** | Aftësitë (sjellja) sipërmarrëse | 3 orë |
| **Tema 3** | Vetvlerësimi i potencialit personal | 3 orë |
| **Tema 4** | Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive | 3 orë |

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 5** | Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja | 4 orë |
| **Tema 6** | Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve | 3 orë |
| **Tema 7** | Etika e komunikimit dhe negocimit | 3 orë |
| **Tema 8** | Puna individuale dhe puna në grup | 4 orë |
| **Tema 9** | Gadishmëria, iniciativa dhe motivimi | 3 orë |
| **Tema 10** | Përgjegjësia individuale dhe shoqërore | 3 orë |
| **Tema 11** | Menaxhimi efiçient i burimeve | 3 orë |
| **Tema 12** | Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes | 3 orë |
| **Tema 13** | Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale | 4 orë |
| **Tema 14** | Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale | 3 orë |
| **Tema 15** | Format e organizimit të sipërmarrjeve | 5 orë |
| **Tema 16** | Konteksti i sipërmarrjeve | 6 orë |
| **Tema 17** | Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve | 4 orë |
| **Tema 18** | Marrëdhëniet e punës | 4 orë |
| **Tema 19** | Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mjedisin e punës | 4 orë |

**2. Lënda "Moda dhe estetika" (L-33-731-25). Kl. 12 – 68 orë**

- **Synimet e lëndës "Moda dhe estetika" kl. 12 - 68 orë.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Moda dhe estetika", kl 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë objektin e studimit të estetikës në veshje.
- Të përshkruajnë kodin e veshjes në kontekste të ndryshme shoqërore dhe kulturore.
- Të përshkruajnë evolimin e kodit të veshjeve gjatë dekadave.
- Të listojnë llojet e kodit të veshjeve në përshtatje me aktivitete apo ngjarje të caktuara.
- Të përshkruajnë karakteristikat, funksionin praktik dhe estetik të veshjeve sipas grupmoshave.
- Të listojnë faktorët që ndikojnë në përzgjedhjen e veshjeve.
- Të shpjegojnë funksionin kryesor të veshjeve.
- Të listojnë shembuj të funksionit të veshjeve sipas profesioneve.
- Të përshkruajnë funksionin e veshjeve si faktor estetik.
- Të listojnë shembuj të funksionit të veshjeve sipas ngjarjeve ose eventeve të caktuara.
- Të përshkruajnë lloje të veshjeve për ngjarje speciale.
- Të listojnë faktorët që ndikojnë në përzgjedhjen e veshjeve.
- Të shpjegojnë funksionin kryesor të veshjeve, por edhe sipas profesioneve dhe situatave.
- Të përshkruajnë evoluimin e tendencave të modës dhe ndryshimet e saj.
- Të përshkruanjë rëndësinë e individualitetit, risitë dhe tendencat në modë.
- Të shpjegojnë tendencat më të fundit në industrinë e modës.
- Të shpjegojnë tendencat e modës dhe estetikës gjatë shekullit XX.
- Të analizojnë tiparet karakteristike te modës dhe estetikës gjatë fillimshekullit të XXI
- Të përshkruajnë linjat kryesore të fustaneve.
- Të përshkruajnë përdorimin e linjave të fustaneve sipas aspektit praktik dhe estetik.
- Të realizojnë kombinime të ndryshme të ngjyrave.

- Të identifikojnë ngjyrat e ngrohta dhe ngjyrat e ftohta.
- Të përshkruajnë efektin psikologjik të ngjyrave.
- Të përshkruajnë rëndësinë, përdorimin dhe kombinimin e ngjyrave sipas stinës.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës *"Moda dhe estetika"*, kl. 12 - 68 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Parimet e estetikës së veshjeve | 2 orë |
| **Tema 2** | Rëndësia e kodit të veshjes | 4 orë |
| **Tema 3** | Funksioni estetik dhe praktik i veshjes sipas grupmoshave | 6 orë |
| **Tema 4** | Linjat e veshjeve në funksionin estetik dhe praktik të tyre | 6 orë |
| **Tema 5** | Veshjet popullore shqiptare dhe modelimi e tyre | 6 orë |
| **Tema 6** | Modelimi i veshjeve sipas modës dhe estetikës | 2 orë |
| **Tema 7** | Individualiteti, risitë dhe tendencat e modës | 4 orë |
| **Tema 8** | Moda gjatë shekullit XX | 8 orë |
| **Tema 9** | Moda gjatë fillimshekullit të XXI | 6 orë |
| **Tema 10** | Linjat kryesore të fustaneve | 6 orë |
| **Tema 11** | Rëndësia e ngjyrave në modelim | 8 orë |
| **Tema 12** | Krijimi i ngjyrave | 6 orë |
| **Tema 13** | Përdorimi i ngjyrave në modë sipas stinës | 4 orë |

## 3. Lënda "Hyrje në programin CAD/CAM" (L-33-732-25). Kl. 12 – 34 orë

- **Synimet e lëndës *"Hyrje në programin CAD/CAM"*, kl. 12 - 34 orë.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës " Hyrje në sistemin CAD/CAM", kl 12, nxënësit duhet:
- Të përshkruajnë aplikimin e sistemit CAD në industrinë tekstile dhe të veshjeve, si dhe përdorimin e programit TukaCAD, Optitex apo Lectra Modaris në dizenjimin dhe modelimin e veshjeve.
- Të përshkruajnë strukturën e programit, elementët e dritares së programit, si dhe komandat e dizenjimit.
- Të tregojnë mënyrën e ndërtimit të figurave gjeometrike, si katror, drejtkëndësh, rreth, elips, si dhe të ndërtojë xhepin,jakën,supanjën,manshetën.
- Të përshkruajnë komandat e elementëve të veçantë të dizenjimit e modelimit, si dhe komandat e përmasave të objekteve e të emërtimit të tyre.
- Të përshkruajnë komandat e shenjave të cikatave .
- Të ndërtojnë rrjetën bazë të linjave konstruktive horizontale dhe vertikale që përcaktojnë gabaritet e hapjeve të detaleve.
- Të tregojnë mënyrën e vendosjes së përmasave, emërtimit të objekteve, si dhe të ndërtojë bazën e fundit nëpërmjet programit CAD/CAM.
- Të tregojnë mënyrën e vendosjes së përmasave, emërtimit të objekteve, si dhe të ndërtojë bazën e bluzës nëpërmjet programit CAD/CAM.
- Të tregojnë mënyrën e vendosjes së përmasave, emërtimit të objekteve, si dhe të ndërtojë bazën e pantallonit nëpërmjet programit CAD/CAM.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës *“Hyrje në programin CAD/CAM”*, kl. 12 - 34 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Sistemet CAD/CAM dhe përdorimi i programeve të ndryshme të CAD për dizenjimin dhe modelimin e veshjeve | 2 orë |
| **Tema 2** | Hyrje në programin CAD | 2 orë |
| **Tema 3** | Komandat e dizenjimit dhe modelimit | 6 orë |
| **Tema 4** | Ndërtimi i figurave gjometrike si (xhepi,jaka,supanja,mansheta) | 4 orë |
| **Tema 5** | Përmasat dhe emërtimi i objekteve. Ndërtimi i bazës së fundit | 4 orë |
| **Tema 6** | Ndërtimi i bazës së bluzës dhe këmishës | 6 orë |
| **Tema 7** | Ndërtimi i bazës së pantallonit | 6 orë |
| **Tema 8** | Ndërtimi i bazës së fustanit | 4 orë |

**4. Lënda “Modelimi i veshjeve” (L-33-733-25). Kl. 12 – 68 orë**

- **Synimet e lëndës “Modelimi i veshjeve” kl. 12 - 68 orë.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Modelimi dhe prerja e veshjeve", kl 12, nxënësit duhet:

- Të realizojnë skicën teknike për modele të ndryshme fundesh(fund i drejtë, i ngushtë, me baskinë, me kinda, me pala, veref etj.).
- Të realizojnë zbërthimin e skicës në kallëpet e prerjes për modele të ndryshme të fundeve.
- Të realizojnë skicën teknike për modele të ndryshme të pantallonave (femra dhe meshkuj).
- Të realizojnë zbërthimin e skicës teknike në kallëpet e prerjes për modele të ndryshme të pantallonave.
- Të skicojnë modele të ndryshme të bluzave (femra dhe meshkuj.
- Të skicojnë modele të ndryshme të këmishave (femra dhe meshkuj).
- Të realizojnë skicat e prerjes për lloje të ndryshme të jakave, xhepave, mëngëve dhe manshetave që përdoren në këmishat e modeluara.
- Të realizojnë zbërthimin e skicave teknike në kallëpet e prerjes për modele të ndryshme të këmishave.
- Të përshkruajnë modele të ndryshme të fustaneve(me penca,pa penca,dopio pet,lloje të ndryshme kindash,prerje poshtë gjoksit, gra shtatzëna, sirena, asimetrike, më palëzime, fustane me lloje të ndryshme mëngësh).
- Të realizojnë skicën teknike për modele të ndryshme të fustaneve.
- Të realizojnë zbërthimin e skicave teknike në kallëpet e prerjes për modele të ndryshme të fustaneve.
- Të skicojnë modele të ndryshme të xhaketave dhe palltove për femra dhe meshkuj.
- Të realizojnë zbërthimin e skicave teknike në kallëpet e prerjes për modele të ndryshme të xhaketave dhe palltove.
- Të skicojnë modele të ndryshme të veshjeve për fëmijë.
- Të realizojnë prerjen e modeleve të veshjeve të ndryshme për fëmijë.
- Të skicojnë modele të ndryshme për veshjet e brendshme.
- Të realizoje kallëpet e prerjeve për modele të ndryshme në veshjet e brendshme.
- Të argumentojnë rëndësinë e zhvillimit të numrave në realizimin e modeleve të veshjeve.
- Të analizojnë grafikisht zhvillimin e numrave në skemën e prerjes.
- Të skicojnë modele të ndryshme të zbukurimeve e aksesorëve që përdoren në veshje.
- Të modelojnë veshje në manekinë, duke u mbështetur në metodën e mulazhit.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës *"*Modelimi i veshjeve*"*, kl. 12 - 68 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Modelimi dhe prerja e fundeve për femra | 6 orë |
| **Tema 2** | Modelimi dhe prerja e pantallonave (femra, meshkuj) | 8 orë |
| **Tema 3** | Modelimi dhe prerja e bluzave dhe këmishave (femra, meshkuj) | 8 orë |
| **Tema 4** | Modelimi dhe prerja e fustaneve | 8 orë |
| **Tema 5** | Modelimi dhe prerja e xhaketave (femra, meshkuj) | 12 orë |
| **Tema 6** | Modelimi dhe prerja e palltove (femra, meshkuj) | 12 orë |
| **Tema 7** | Modelimi dhe prerja e veshjeve për fëmijë | 4 orë |
| **Tema 8** | Modelimi dhe prerja e veshjeve të brendshme | 4 orë |
| **Tema 9** | Zhvillimi i numrave në skemën e prerjes | 2 orë |
| **Tema 10** | Modelimi i veshjeve nëpërmjet mulazhit | 4 orë |

# IX. Përshkruesit e moduleve të detyruar të praktikës profesionale

## 1. Moduli "Planifikimi dhe organizimi i punës në modelim"

**Kualifikimi: Modelim**
**Niveli: III i KSHK**
**Klasa: 12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe Kodi** | **PLANIFIKIMI DHE ORGANIZIMI I PUNËS NË MODELIM** | **M-10-2155-25** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që aftëson nxënësit për të planifikuar dhe organizuar vendin e punës, burimet njerëzore dhe proceset e punës gjatë modelimit të veshjeve. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 68 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK të kualifikimit profesional "Tekstil – Konfeksion". | |
| **Rezultatet e të nxënit (RN) dhe proçedurat e vlerësimit** | **RN 1** | **Nxënësi organizon vendin e punës në atelie.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;<br>- të përzgjedh makinat qepëse të nevojshme pë realizimin e proceseve të punës në atelie;<br>- të përzgjedh makinat prerëse të nevojshme pë realizimin e proceseve të punës në atelie;<br>- të përzgjedh tavolinën e punës për ndërtimin e kallëpeve dhe prerjen e tekstileve;<br>- të përzgjedh makinat hekurosëse të nevojshme për realizimin e proceseve të punës;<br>- të përzgjedhë tekstilet e nevojshme;<br>- të përzgjedhë penjtë, gjilpërat, gërshërët dhe materialet e tjera ndimëse;<br>- të përzgjedhë llojet e manekinave të nevojshme për realizimin e proceseve të punës;<br>- të organizojë dhe ndajë hapësirat e punës në atelie;<br>- të organizojë hapësirën e procesit të prerjes dhe ndërtimit të kallëpeve;<br>- të organizojë hapësirën e procesit të qepjes në atelie;<br>- të organizojë vendosjen e makinerive sipas proceseve të punës; |

- të organizojë hapësirën e hekurosjes, makinerive dhe tavolinës së hekurosjes;
- të organizojë dhomën e provës;
- të organizojë ambjentin e pritjes së klientit;
- të kontrollojë funksionalitetin e makionave prerëse;
- të kontrollojë funksionalitetin e makionave qepëse;
- të kontrollojë funksionalitetin e makinave hekurosëse;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të organizimit të vendit të punës
- të kryejë një preventiv të kostove për organizimin e vendit të punës;
- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë të organizimit të vendit të punës;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë të organizimit të vendit të punës.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 2 Nxënësi planifikon burimet njerëzore në atelie.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të shqyrtojë kërkesa nga sektorë të ndryshëm për vende të lira pune;
- të hartojë njoftimin për vende të lira pune;
- të hartojë një CV dhe një letërmotivim;
- të kryejë grumbullimin dhe përzgjedhjen e CV-ve;
- të përcaktojë shkallën e kualifikimit të punëtorëve;
- të përzgjedh personat që merren me marketingun;
- të identifikojë aftësitë menaxhuese;
- të realizojë intervista me aplikantët;
- të kryejë përzgjedhjen e aplikantëve,
- të kryejë hartimin e kontratës,
- të përcaktojë detyrat e punonjëve për pozicione të ndryshme pune;
- të evidentojë rregullat higjieno-sanitare që duhet të ndjekin punonjësit në varësi të proceseve të punës;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të planifikimit të burimeve njerëzore;
- të kryejë një preventiv të kostove për planifikimin e burimeve njerëzore;

- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë planifikimit të burimeve njerëzore;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë planifikimit të burimeve njerëzore.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 3 Nxënësi planifikon dhe organizon proceset e punës në atelie.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të organizojë ndarjen e punës në ekip;
- të planifikojë veprimtarinë ditore, javore dhe mujore;
- të planifikojë rradhën e punës në varësi të produktit;
- të planifikojë kohën e realizimit të produktit;
- të planifikojë provën e produktit;
- të organizojë skedarët e kallëpeve;
- të realizojë raportimin e punës së kryer;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të organizimit të proceseve të punës;
- të kryejë një preventiv të kostove për proceset që do të kryen;
- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë organizimit të punës;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë organizimit të punës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

| | |
|---|---|
| **Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.** | - Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në atelie<br>- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime të mënyrave të organizimit të vendit, mjeteve dhe proceseve të punës në atelie.<br>- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për organizimin dhe strukturimin e vendit të punës në mënyrë sa më efektive në varësi të proçeseve të punës që do të kryhen.<br>- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve.<br>- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për organizimin e proçeseve të punës në atelie, për përzgjedhjen dhe organizimin e |

| | |
|---|---|
| | stafit në varësi të afësive dhe kualifikimit personal të tyre.<br>- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet plotësimi nga nxënësi i të gjitha kritereve të realizimit të çdo rezultati mësimor të modulit. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:<br>- repart pune;<br>- pajisjet dhe mjetet e punës për kryerjen e proçeseve të punës në atelie;<br>- lëndë të para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin e punës në atelie;<br>- materiale të shkruara në mbështetje të modulit. |

**2. Moduli “Marrja e masave dhe përgatitja e kallëpeve”**

**Kualifikimi: Modelim**
**Niveli: III i KSHK**
**Klasa: 12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe Kodi** | **MARRJA E MASAVE DHE PËRGATITJA E KALLËPEVE** | **M-33-2156-25** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që aftëson nxënësit për të realizuar marrjen e masave trupore dhe përgatitjen e kallëpeve bazë të bluzës dhe pantallonit për femra dhe meshkuj. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 34 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, të kualifikimit profesional “Tekstil – Konfeksion”. | |
| **Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit** | **RN 1** **Nxënësi merr masat trupore.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;<br>- të përzgjedhë materialet e nevojshme, që nevojiten për marrjen e masave trupore për femra dhe meshkuj;<br>- të identifikojë masat trupore, që merren në gjatësi të trupit për femra;<br>- të identifikojë masat trupore, që merren në gjerësi të trupit për femra;<br>- të identifikojë masat trupore, që merren në gjatësi të trupit për meshkuj;<br>- të identifikojë masat trupore, që merren në gjerësi të trupit për meshkuj;<br>- të marrë masat trupore për femra;<br>- të marrë masat trupore për meshkuj;<br>- të shënojë masat trupore të marra për femra dhe meshkuj;<br>- të nxjerrë masat trupore nga tabela e përmasave;<br>- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të marrjes së masave trupore;<br>- të kryejë një preventiv të kostove për proceset që do të kryen;<br>- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë marrjes së masave trupore; | |

- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë marrjes së masave trupore.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 2 Nxënësi përgatit kallëpe të modele të bluzave për femra dhe meshkuj.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e nevojshme për ndërtimin dhe prerjen e pjesëve të modelit;
- të vendosë saktë raportet trupore në vizatim;
- të realizojë përputhjen e modelit me individin;
- të vizatojë skemën gjeometrike të modelit të bluzës;
- të zbërthejë pjesët përbërëse të detaleve dhe elementëve për bluzat e modeluara;
- të ndërtojë kallëpin e bluzës me modele të ndryshme të spostimit të pencave për femra;
- të ndërtojë kallëpin e bluzës me modele të ndryshme jakash për femra;
- të ndërtojë kallëpin e bluzës me modele të ndryshme mëngësh për femra;
- të ndërtojë kallëpin e bluzës së modeluar me mëngë regland;
- të ndërtojë kallëpin e bluzës së modeluar me mëngë kimono;
- të ndërtojë kallëpin e bluzave të modeluara për meshkuj;
- të ndërtojë kallëpin e këmishave të modeluara për femra dhe meshkuj;
- të vendosë cikatjet dhe shenjat e referimit në vendet e duhura;
- të kontrollojë saktësinë e skicave të prerjes;
- të vendosë në mënyrën e duhur kallëpet mbi tekstil, duke ekonomizuar lëndën e parë;
- të presë elementët përkatës dhe detalet e bluzës së modeluar ;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të përgatitjes së kallëpe të modele të bluzave për femra dhe meshkuj;
- të kryejë një preventiv të kostove për proceset që do të kryen;
- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë përgatitjes së kallëpe të modele të bluzave për femra dhe meshkuj;

- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë përgatitjes së kallëpe të modele të bluzave për femra dhe meshkuj.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 3 Nxënësi përgatit kallëpe të modeleve të pantallonave për femra dhe meshkuj.**

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e nevojshme për ndërtimin dhe prerjen e pjesëve të modelit;
- të vendosë saktë raportet trupore në vizatim;
- të realizoj përputhjen e modelit me individin;
- të vizatojë skemën gjeometrike të modelit të pantallonit;
- të zbërthejë pjesët përbërëse të detaleve dhe elementëve të pantallonave të modeluara;
- të ndërtojë kallëpet e pantallonave të modeluara për femra;
- të ndërtojë kallëpet e pantallonave të modeluara për meshkuj;
- të ndërtojë kallëpet e fund-pantallonave të modeluara për femra;
- të vendosë cikatjet dhe shenjat e referimit në vendet e duhura;
- të kontrollojë saktësinë e skicave të prerjes;
- të vendosë në mënyrën e duhur kallëpet mbi tekstil, duke ekonomizuar lëndën e parë;
- të presë elementët përkatës dhe detalet e pantallonave të modeluar;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të përgatitjes së kallëpe të modele të pantallonave për femra dhe meshkuj;
- të kryejë një preventiv të kostove për proceset që do të kryen;
- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë përgatitjes së kallëpe të modele të pantallonave për femra dhe meshkuj;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë përgatitjes së kallëpe të modele të pantallonave për femra dhe meshkuj.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli.

| | |
|---|---|
| **Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.** | - Ky modul duhet të trajtohet në repartin e modelimit.<br>- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë që është e mundur demonstrimet konkrete për marrjen e masave trupore për femra dhe meshkuj.<br>- Nxënësi duhet të angazhohet në punë konkrete për përgatitjen e kallepeve të bluzave, këmishave dhe pantallonave të modeluara për femra dhe meshkuj.<br>- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të zbatohet vlerësimi mbi bazën e demostrimit praktik të aftësive dhe njohurive të fituara.<br>- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet plotësimi nga nxënësi i të gjitha kritereve të realizimit të çdo rezultati mësimor të modulit. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:<br>- Kompleti i veglave dhe materialeve për marrjen e masave dhe prerjen e bluzave, këmishave dhe pantallonave të modeluara për femra dhe meshkuj.<br>- Udhëzues, rregullore për kushtet teknike për marrjen e masave dhe përgatitjen e kallëpeve të bluzave, këmishave dhe pantallonave të modeluara për femra dhe meshkuj. |

## 3. Moduli “Realizimi i prototipit”

**Kualifikimi:** **Modelim**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe Kodi** | **REALIZIMI I PROTOTIPIT** | **M-33-2157-25** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që aftëson nxënësit në realizimin e prototipit (vizatimit, skicimit, zbërthimit dhe prerjes) të veshjeve të modeluara për femra dhe meshkuj. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 84 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK të kualifikimit profesional “Tekstil – Konfeksion”. | |
| **Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit** | **RN 1** | **Nxënësi përgatit dhe pret modele të fundeve për femra.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;<br>- të përzgjedhë materialet e nevojshme për ndërtimin dhe prerjen e pjesëve të modelit;<br>- të vendosë saktë raportet trupore në vizatim;<br>- të realizojë përputhjen e modelit me individin;<br>- të realizojë skemën gjeometrike (të shoqëruara me prerje) të modeleve të ndryshme të fundeve me supanjë për femra;<br>- të realizojë skemën gjeometrike (të shoqëruara me prerje), të modeleve të ndryshme të fundeve me xhepa për femra;<br>- të realizojë skemën gjeometrike (të shoqëruara me prerje) të modeleve të ndryshme të fundeve veref për femra;<br>- të zbërthejë pjesët përbërëse të detaleve dhe elementëve të tjerë për modelet e fundeve për femra;<br>- të realizojë vizatimin në manekinë të përpjestimeve dhe figurës gjometrike të fundeve;<br>- të vizatojë modele të ndryshme të fundeve;<br>- të ndërtojë skicat e prerjes së pjesëve të ndryshme të fundeve të modeluar me xhepa, me supanjë, veref;<br>- të përshtasë materialin e tekstilit me modelin dhe funksionin e veshjes;<br>- të vendosë në mënyrën e duhur kallëpet në teksil duke ekonomizuar lëndën e parë; |

- të presë kallëpet e modeleve të fundeve;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të realizimit të prototipit së modeleve të fundeve për femra;
- të kryejë një preventiv të kostove për proceset që do të kryen;
- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë realizimit të prototipit të modeleve të fundeve për femra;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë realizimit të prototipit të modele të fundeve për femra.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 2 Nxënësi përgatit dhe pret modele të fustaneve për femra.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e nevojshme për ndërtimin dhe prerjen e pjesëve të modelit;
- të vizatojë skemën gjeometrike të modelit të fustanit të shoqëruar me prerje;
- të vendosë saktë raportet trupore në vizatim;
- të realizojë përputhjen e modelit me individin;
- të zbërthejë pjesët përbërëse të detaleve dhe elementëve për modelet e fustaneve;
- të ndërtojë kallëpet e fustaneve të modeluar me penca;
- të ndërtojë kallëpet e fustaneve të modeluar me kapërcim;
- të ndërtojë kallëpet të modeleve të fustaneve për mbëmje;
- të përshtasë materialin e tekstilit me modelin dhe funksionin e veshjes;
- të vendosë në mënyrën e duhur kallëpet mbi tekstil duke ekonomizuar lëndën e parë;
- të presë elementët përkatës dhe detalet e fustaneve;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të realizimit të prototipit së modeleve të fustaneve për femra;
- të kryejë një preventiv të kostove për proceset që do të kryen;
- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë realizimit të prototipit të modeleve të fustaneve për femra;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit e materialeve, gjatë realizimit të prototipit të modele të fustaneve për femra.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 3 Nxënësi përgatit dhe pret modele të xhaketave për femra dhe meshkuj.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e nevojshme që nevojiten për ndërtimin e modeleve të ndryshme;
- të zbërthejë pjesët përbërëse të modeleve të ndryshme të xhaketave për femra dhe meshkuj;
- të ndërtojë kallëpet e pjesëve të ndryshme të xhaketave të modeluara për femra dhe meshkuj;
- të kontrollojë saktësinë e skicave;
- të përshtasë materialin e tekstilit me llojin e modelit dhe funksionin e veshjes;
- të rregullojë defektet trupore në kallëpin e prerjes;
- të përshtasë materialin e tekstilit me modelin dhe funksionin e veshjes;
- të vendosë në mënyrën e duhur kallëpet mbi tekstil duke ekonomizuar lëndën e parë;
- të realizojë prerjen e elementëve dhe detaleve të modeleve të ndryshme të xhaketave për femra dhe meshkuj;
- të vendosë cikatjet dhe shenjat e referimit në vendet e duhura që korrespondojnë me pjesët e tjera;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të realizimit të prototipit së modeleve të xhaketave për femra dhe meshkuj;
- të kryejë një preventiv të kostove për proceset që do të kryen;
- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë realizimit të prototipit të modeleve të xhaketave për femra dhe meshkuj;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë realizimit të prototipit të modele të xhaketave për femra dhe meshkuj.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 4 Nxënësi përgatit dhe pret modele të palltove për femra dhe meshkuj.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e nevojshme që nevojiten për ndërtimin e modeleve të ndryshme;

| | |
|---|---|
| | - të zbërthejë pjesët përbërëse të modeleve të ndryshme të palltove për femra dhe meshkuj;<br>- të ndërtojë kallëpet e pjesëve të ndryshme të palltove të modeluara për femra dhe meshkuj;<br>- të bëjë kontrollin e saktësisë së skicave;<br>- të përshtasë materialin e tekstilit me modelin dhe funksionin e veshjes;<br>- të vendosë në mënyrën e duhur kallëpet mbi tekstil duke ekonomizuar lëndën e parë;<br>- të realizojë prerjen e elementëve dhe detaleve të modeleve të ndryshme të palltove për femra dhe meshkuj;<br>- të vendosë cikatjet dhe shenjat e referimit në vendet e duhura që korrespondojnë me pjesët e tjera;<br>- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të realizimit të prototipit së modeleve të palltove për femra dhe meshkuj;<br>- të kryejë një preventiv të kostove për proceset që do të kryen;<br>- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë realizimit të prototipit të modeleve të palltove për femra dhe meshkuj;<br>- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë realizimit të prototipit të modele të palltove për femra dhe meshkuj.<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>- Vëzhgim me listë kontrolli. |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.** | - Ky modul duhet të trajtohet në repartin e prerjes/modelimit si dhe te organizohen vizita njohëse në ndërmarrje të konfeksionit.<br>- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë që është e mundur demonstrimet konkrete për modelimin,zbërthimin dhe prerjen e veshjeve të modeluar për femra dhe meshkuj.<br>- Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për modelimin, zbërthimin dhe prerjen e veshjeve të modeluar (funde, fustane, xhaketa, pallto) për femra dhe meshkuj.<br>- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të zbatohet vlerësimi mbi bazën e demostrimit praktik të aftësive dhe njohurive të fituara.<br>- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet plotësimi nga nxënësi i të gjitha kritereve të realizimit të çdo rezultati mësimor të modulit. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme: |

| | | |
|---|---|---|
| **modulit** | - | Kompleti i veglave dhe materialeve për modelimin,  zbërthimin dhe prerjen e veshjeve të modeluara. |
| | - | Udhëzues, rregullore për kushtet teknike për modelimin, dhe prerjen e veshjeve të modeluara . |

**4. Moduli "Konfeksionimi i produktit"**

**Kualifikimi: Modelim**
**Niveli: III i KSHK**
**Klasa: 12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe Kodi** | **KONFEKSIONIMI I PRODUKTIT** | **M-33-2158-25** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer qepjen dhe procese përfundimtare të veshjeve të modeluara për femra dhe meshkuj. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 120 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, të kualifikimit profesional "Tekstil – Konfeksion". | |
| **Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit** | **RN 1** | **Nxënësi kryen konfeksionimin e fundeve të modeluara për femra.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepjen dhe kryerjen e proceseve përfundimtare të fundeve të modeluara;<br>- të përzgjedhë materialet e nevojshme që nevojiten për realizimin e provës së fundeve të modeluara;<br>- të ildisë pjesët përbërëse dhe detalet e modeleve të fundeve;<br>- të kryejë provën e qëndrimit në trup të fundeve të modeluara;<br>- të kostatojë defektet e ndryshme pas provës;<br>- të korrigjojë defektet e ndryshme pas provës;<br>- të presë me saktësi astarin;<br>- të presë me saktësi qemerin;<br>- të përzgjedhë makinat qepëse për realizimin e kampionit të modelit;<br>- të qepë astarin sipas modelit;<br>- të qepë tekstilin sipas modelit;<br>- të qepë qemerin sipas modelit;<br>- të qepë zinxhirin sipas modelit;<br>- të realizojë tegela të ndryshëm zbukurues në modelet e ndryshme të fundeve;<br>- të hekurosë në varësi të modelit dhe materialit; |

- të përdorë teknologjinë digjitale për konfeksionimin e fundeve të modeluara për femra;
- të kryejë një llogaritje të kostove për fundet e modeluara për femra të realizuara;
- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë konfeksionimit të fundeve të modeluara për femra;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë konfeksionimit të fundeve të modeluara për femra.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 2 Nxënësi kryen konfeksionimin e bluzave të modeluara për femra dhe meshkuj.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materjalet e nevojshme;
- kryejë provën e modeleve të ndryshme të bluzave të modeluara për femra dhe meshkuj;
- të kostatojë defektet e ndryshme pas provës;
- të korigjojë defektet e ndryshme pas provës;
- të përzgjedhë makinat qepëse për realizimin e kampionit të modelit;
- të qepë kampionin e modelit;
- të vendosë aksesorë zbukurues;
- të qepë me tegel të sipërm dekorues mostrat;
- të hekurosë në varësi të modelit dhe materjalit;
- të përdorë teknologjinë digjitale për konfeksionimin e bluzave të modeluara për femra e meshkuj;
- të kryejë një llogaritje të kostove për bluza të modeluara të realizuara;
- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë konfeksionimit të bluzave të modeluara për femra e meshkuj;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë konfeksionimit të bluzave të modeluara për femra e meshkuj.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 3 Nxënësi kryen konfeksionimin e pantallonave të modeluara për femra dhe meshkuj.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepjen dhe kryerjen e proceseve përfundimtare të modeleve të pantallonave për femra dhe meshkuj;
- të frazelinojë me kujdes qemerin;
- të ildisë pjesët e ndryshme të pantallonave;
- të ildisë palat e pantallonave;
- të kryejë provën e parë të qëndrimit në trup të pantallonave;
- të kryejë rregullimin e pantallonave pas kryerjes së provës;
- të përzgjedhë makinat qepëse për realizimin e kampionit të modelit;
- të qepë kampionin e modelit;
- të vendosë aksesorë zbukurues;
- të qepë me tegel të sipërm dekorues;
- të hekurosë në varësi të modelit dhe materialit;
- të përdorë teknologjinë digjitale për konfeksionimin e pantallonave të modeluara për femra e meshkuj;
- të kryejë një llogaritje të kostove për pantallona të modeluara të realizuara;
- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë konfeksionimit të pantallonave të modeluara për femra e meshkuj; ;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë konfeksionimit të pantallonve të modeluara për femra e meshkuj.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 4 Nxënësi kryen konfeksionimin e fustaneve të modeluara për femra.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për kryerjen e qepjes dhe proceseve përfundimtare të fustaneve të modeluara;
- të ildisë pjesët e ndryshme të fustaneve të modeluara;
- të kryejë provën e parë të qëndrimit në trup të fustaneve të modeluara;
- të kryejë rregullimin e fustaneve pas kryerjes së provës;
- të përzgjedhë makinat qepëse dhe hekurosëse për realizimin e kampionit;
- të bashkojë me tegel pjesët e fustanit të modeluar ;
- të kryejë vendosjen e aksesorëve në fustanet e modeluara ;

- të kryejë hekurosjen e fustanit ;
- të vendosë elementë zbukurues në fustan ;
- të kryejë pastrimin e fijeve ;
- të përdorë teknologjinë digjitale për konfeksionimin e fustaneve të modeluara për femra;
- të kryejë një llogaritje të kostove për fustane të modeluara të realizuara;
- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë konfeksionimit të fustaneve të modeluara për femra;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë konfeksionimit të fustaneve të modeluara për femra.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 5 Nxënësi kryen konfeksionimin e xhaketave të modeluara për femra dhe meshkuj.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepjen dhe kryerjen e proçeseve përfundimtare të xhaketës së modeluara për femra dhe meshkuj;
- të përzgjedhë makinat qepëse për realizimin e kampionit të modelit;
- të përzgjedhë materialet e nevojshme për realizimin e provave;
- të përgatisë xhaketat për kryerjen e provave përkatëse;
- të kryej provën e parë të xhaketave të modeluara per femra dhe meshkuj;
- të kopjojë me penjë-kopjues shënimet nga pjesët e lartme në ato të poshtme të shpinës dhe përparëses;
- të qepë xhepat (sipas llojit të modelit);
- të bashkojë me ildi shpinën me përparësen e xhaketës;
- të kryejë provën e parë të qëndrimit në trup të xhaketës;
- të identifikojë modifikimet të cilat janë të nevojshme në gavaturë dhe në linjën e xhaketës;
- të modifikojë xhaketën pas kryerjes së provës së parë;
- të vendosë përforcuesin përgjatë gjatësisë së petës si dhe tek thyerja e saj;
- të qepë trupin e xhaketës;
- të qepë mostrat në përparëset, duke i dhënë mulesat e duhura mostrave nga peta e lart dhe xhaketës nga peta e poshtë;
- të kthejë mostrat nëpërmjet ildive, duke bërë të mbivendoset peta nga thyerja e saj e lart dhe të

mbivendoset xhaketa (sipas modelit) nga kopsa e poshtë;
- të qepë trupin e xhaketës (sipas modelit);
- të frazelinojë pjesën e poshtme të xhaketës (sipas modelit) dhe mëngët;
- të bashkojë shpinën me përparëset e xhaketës (sipas modelit);
- të pëgatisë astarin me xhaketën (sipas modelit);
- të qepë trupin e astarit me përparëset;
- të kthejë palën e xhaketës nëpërmjet ildisë;
- të bashkojë pjesët e jakës (sipas modelit) së poshtme;
- të japë formën e duhur jakës së poshtme;
- të qepë kanavacën duke i dhënë formën e duhur kamës së jakës dhe jakës nëpërmjet kllapave;
- të ildisë jakën e poshtme në xhaketë;
- të përgatisë mëngën për qepje (sipas modelit);
- të qepë hapjet e mëngëve;
- të kryejë bashkimin e mëngës (sipas modelit);
- të hekurosë rafitë e mëngës;
- të qepë astarët e mëngëve;
- të qepë gavaturat e xhaketës, për ruajtjen e formës nëpërmjet ildive përforcuese;
- të ildisë mëngët në xhaketë, duke i dhënë mulesat e duhura;
- të kryejë provën e dytë të qëndrimit në trup, duke parë qëndrimin e saj, mulesat në kokën e mëngës, shtrimin e jakës;
- të rregullojë xhaketën pas provës së dytë;
- të përzgjedhë makinat qepëse për realizimin e kampionit të modelit;
- të qepë harkun e qafës së shpinës së astarit me jakën;
- të qepë astarin me palën e xhaketës dhe me hapjen e shpinës (cika);
- të qepë astarët e mëngëve me kthesën e mëngëve;
- të hekurosë astarin;
- të fiksojë jakën e sipërme me astarin;
- të fiksojë astarin me gavaturën dhe rafitë anësore;
- të kthejë pallton;
- të qepë kampionin e modelit;
- të vendosë aksesorë zbukurues;
- të qepë me tegel të sipërm dekorues;
- të hekurosë kampionin duke përdorur pëlhurë;
- të pastrojë xhaketën nga penjtë;
- të përdorë teknologjinë digjitale për konfeksionimin e xhaketave të modeluara për femra e meshkuj;
- të kryejë një llogaritje të kostove për xhaketa të modeluara të realizuara;

- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë konfeksionimit të xhaketave të modeluara për femra e meshkuj;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë konfeksionimit të xhaketave të modeluara për femra e meshkuj.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 6 Nxënësi kryen konfeksionimin e palltove të modeluara për femra dhe meshkuj.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepjen dhe kryerjen e proçeseve përfundimtare të palltos së modeluara për femra dhe meshkuj;
- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për përgatitjen e palltos për provën e parë;
- të kopjojë me penjë-kopjues shënimet nga pjesët e lartme në ato të poshtme të palltos;
- të frazelinojë përparëset e palltos;
- të ildisë pensat e përparëses;
- të bashkojë me ildi pjesët e shpinës;
- të bashkojë me ildi shpinën me përparëset e palltos;
- të bashkojë me ildi mëngët sipas modelit;
- të kryejë provën e parë të qëndrimit në trup të palltos;
- të identifikojë modifikimet të cilat janë të nevojshme në linjën e palltos, pensat, harkun e qafës si dhe të gavaturës;
- të rregullojë pallton pas kryerjes së provës së parë, duke hapur supet;
- të qepë xhepat sipas modeleve në përparësen e palltos;
- të qepë shpinën;
- të hekurosë shpinën;
- të frazelinojë mostrat;
- të qepë mostrat në përparëse, duke i dhënë mulesat e duhura;
- të frazelinojë harkun e gavaturës dhe të qafës së shpinës;
- të bashkojë shpinën me përparëset e palltos me makinë;
- të frazelinojë jakën e poshtme;
- të qepë jakën e poshtme;
- ti japë formën e duhur jakës së poshtme me hekur;
- të ildisë jakën e poshtme në pallto;
- të frazelinojë hapjen dhe fundin e mëngës;
- të qepë pjesët e mëngëve sipas modelit;
- të kryejë bashkimin e mëngës;

- të hekurosë rafitë e mëngës;
- të bashkojë pjesët e astarit me njëra-tjetrën, duke lenë një hapësirë në bashkimin e mëngës së majtë për kthimin e palltos;
- të bashkojë përparëset e astarit me mostrat;
- të bashkojë supet e astarit;
- të hekurosë rafitë e qepjes së astarit;
- të kryejë provën e dytë të qëndrimit në trup të palltos (sipas modelit);
- të identifikojë defektet në qëndrimin e jakës dhe të mëngës, përcaktimin e gjatësisë së palltos dhe mëngëve (sipas modelit);
- të modifikojë defektet e konstatuara pas provës së dytë të palltos (sipas modelit);
- të qepë harkun e qafës së shpinës së astarit me jakën;
- të qepë astarin me palën e palltos dhe me hapjen e shpinës (cika);
- të qepë astarët e mëngëve me kthesën e mëngëve;
- të hekurosë astarin;
- të fiksojë jakën e sipërme me astarin;
- të fiksojë astarin me gavaturën dhe rafitë anësore;
- të kthejë pallton;
- të përzgjedhë makinat qepëse për realizimin e kampionit të modelit;
- të vendosë zbukurime dhe aksesorë(kopsa,dekorime të ndryshme etj);
- të përdorë mënyrat e hekurosjes në varësi të materialit të kampionit;
- të përdorë teknologjinë digjitale për konfeksionimin e palltove të modeluara për femra e meshkuj;
- të kryejë një llogaritje të kostove për pallto të modeluara të realizuara;
- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë konfeksionimit të palltove të modeluara për femra e meshkuj;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë konfeksionimit të palltove të modeluara për femra e meshkuj.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

| | |
|---|---|
| **Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.** | - Ky modul duhet të trajtohet në repartin e rrobaqepësisë si dhe te organizohen vizita njohëse në ndërmarrje të konfeksionit. |

| | |
|---|---|
| | - Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë që është e mundur demonstrimet konkrete për qepjen e veshjeve të modeluar për femra dhe meshkuj.<br>- Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për qepjen e veshjeve të modeluar për femra dhe meshkuj.<br>- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të zbatohet vlerësimi mbi bazën e demostrimit praktik të aftësive dhe njohurive të fituara.<br>- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet plotësimi nga nxënësi i të gjitha kritereve të realizimit të çdo rezultati mësimor të modulit. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:<br>- Kompleti i veglave dhe materialeve qepjen e veshjeve të modeluara për femra dhe meshkuj.<br>- Udhëzues, rregullore për kushtet teknike për qepjen veshjeve të modeluara. |

**5. Moduli "Kryerja e kontrollit të cilësisë, gjatë modelimit të veshjeve."**

**Kualifikimi: Modelim**
**Niveli: III i KSHK**
**Klasa: 12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe Kodi** | **KRYERJA E KONTROLLIT TË CILËSISË GJATË MODELIMIT TË VESHJEVE** | **M-33-2159-25** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që aftëson nxënësit për të identifikuar dhe korrigjuar defektet gjatë proceseve të ndërtimit të kallëpeve, prerjes së elementëve përbërës dhe konfeksionimit të veshjeve të modeluara për femra dhe meshkuj. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 34 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, të kualifikimit profesional "Tekstil – Konfeksion". | |
| **Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit** | **RN 1** **Nxënësi kryen kontrollin e cilësisë së elementëve të kallëpeve të veshjes.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;<br>- të përzgjedhë materialet e nevojshme që nevojiten për kontrollin e saktësisë së elementëve përbërës të kallëpeve;<br>- të kryejë kontrollin e saktësisë së elementëve të veshjes me letër në manekinë;<br>- të kryejë kontrollin e saktësisë së elementëve të veshjes me tekstil në manekinë;<br>- të kryejë kontrollin e saktësisë së elementëve të veshjes me anën e provës digitale me softëare të ndryshëm;<br>- të evidentojë defektet në kallëpin e veshjes;<br>- të kryejë korrigjimin e defekteve në kallëpin e veshjes;<br>- të përdorë teknologjinë digjitale gjatë kontrollit të cilësisë së elementëve të kallëpeve të veshjes;<br>- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë kontrollit të cilësisë së elementëve të kallëpeve të veshjes;<br>- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë kontrollit të cilësisë së elementëve të kallëpeve të veshjes.<br>***Instrumentet e vlerësimit:*** | |

| | | |
|---|---|---|
| | | - Vëzhgim me listë kontrolli. |
| | **RN 2** | **Nxënësi kryen kontrollin e cilësisë së qepjes së veshjes.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;<br>- të  përzgjedhë materialet e nevojshme, që nevojiten për relizimin e kontrollit të cilësisë në qepje;<br>- të kontrollojë respektimin e bashkimit të cikatave;<br>- të kryejë kontrollin e respektimit të tolerancave të qepjes në pjesë të ndryshme të veshjes;<br>- të kryejë kontrollin e tegelave të makinës;<br>- të kryejë kontrollin e forcimit të tegelit në pjesë të ndryshme të veshjes;<br>- të kryejë kontrollin e pastërtisë së qepjes së elementëve të ndryshëm të veshjes;<br>- të kontrollojë saktësinë e hekurosje së pjesëve të veshjes;<br>- të kontrollojë pastrimin e veshjes nga fijet;<br>- të përdorë teknologjinë digjitale gjatë kontrollit të cilësisë së qepjes së veshjes;<br>- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë kontrollit të cilësisë së qepjes së veshjes;<br>- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë kontrollit të cilësisë së qepjes së veshjes.<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>- Vëzhgim me listë kontrolli. |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.** | | - Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në reparte të  rrobaqepsisë<br>- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të proceseve për kryerjen e kontrollit të cilësisë të proceseve të krijimit të veshjeve.<br>- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për kontrollin e cilësis gjatë procesit të ndërtimit të kallëpeve, prerjes së pjesëve të veshjes dhe qepjes së tyre.<br>- Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve.<br>- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve mbi  kontrollin e cilësisë së proçeseve të krijimit të veshjeve.<br>- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet plotësimi |

| | |
|---|---|
| | nga nxënësi i të gjitha kritereve të realizimit të çdo rezultati mësimor të modulit. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:<br>- repart rrobaqepsie;<br>- pajisjet dhe mjetet e punës së rrobaqepësit;<br>- lëndë të para dhe ndihmëse për ndërtimin e kallëpeve dhe qepjen e veshjeve.<br>- Pajisje teknologjike digjitale, që garantojnë kontrollin e duhur të cilësisë së ndërtimit të kallëpeve, prerjes së pjesëve të veshjes dhe qepjes së tyre. |

**6. Moduli “Komunikimi dhe etika profesionale gjkatë modelimit të veshjeve”**

**Kualifikimi:** **Modelim**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **KOMUNIKIMI DHE ETIKA PROFESIONALE GJATË MODELIMIT TË VESHJEVE** | **M-38-2160-25** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të komunikuar dhe udhëhequr bisedat me klientët dhe bashkëpunëtorët, duke njohur kërkesat e tyre dhe duke i nxituar ata për blerje reale. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 34 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, të kualifikimit profesional “Tekstil – Konfeksion”. | |
| **Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit** | **RN 1** | **Nxënësi krijon raporte njerëzore dhe profesionale të suksesshme në vendin e punës.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>- të identifikojë aftësitë e buta, si çelësi i komunikimit të efektshëm në ndërmarrje;<br>- të demostrojë aftësinë për të kuptuar këndvështrimet e të tjerëve;<br>- të adresojë drejt dhe saktë problematikat, që mund të lindin;<br>- të zhvillojë aftësinë e përshtatjes, gjatë komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm;<br>- të zbatojë rregullat e komunikimit me klientët dhe bashkëpunëtorët duke përdorur inteligjencën emocionale;<br>- të demonstrojë interesim dhe entusiazëm në vendin e punës;<br>- të demonstrojë qëndrime pozitive;<br>- të demonstrojë veti për të qenë bashkëveprues;<br>- të demonstrojë sinqeritet, qetësi dhe taktikë;<br>- të demonstrojë gatishmërinë për të pranuar vërejtjet dhe për t’i shfrytëzuar ato në mënyrë konstruktive;<br>- të demonstrojë dëshirën/ gatishmërinë për të pranuar përgjegjësitë e punës;<br>- të demonstrojë veti pozitive personale (qetësi, empati, vetë-kontroll, gjakftohtësi, fleksibilitet, besueshmëri, iniciativë krijues, etj,.); |

- të zbatojë kodin etik të veshjes;
- të demonstrojë etikë në punë (korrektësi, ndershmëri, etj,.)
- të ruajë gjithmonë konfidencialitetin e firmës/biznesit, ku është i punësuar;
- të zbatojë kurdoherë rregullat dhe protokollin e ndërmarrjes;
- të respektojë konfidencialitetin dhe standardet e ndryshme kulturore, racore të klientëve;
- të shfaqë aftësi kritike të menduarit për zgjidhjen e problemeve;
- të nxisë punën në grup për të përmirësuar cilësinë e punës;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të krijimit të raporteve njerëzore dhe profesionale të suksesshme në vendin e punës.
- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë krijimit të raporteve njerëzore dhe profesionale të suksesshme në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë krijimit të raporteve njerëzore dhe profesionale të suksesshme në vendin e punës.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 2 Nxënësi pret dhe informon klientët.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të presë dhe akomodojë klientin në mënyrën e duhur;
- të informojë saktë, qartë, në kohën dhe mënyrën e përshtatshme, klientin mbi ndërmarrjen dhe produktet e saj;
- të përdorë me efektivitet mënyra të ndryshme komunikimi me klientët;
- të përcaktojë drejt mënyrën e përshtatshme të komunikimit në varësi të llojit të klientit dhe kërkesave të tij;
- të identifikojë saktë arsyet, që e shtyjnë klientin për të blerë në varësi të mundësive të tij ekonomike dhe klasës ose shtresës shoqërore;
- të trajtojë me korrektësi, individualisht,çdo klient potencial;
- të krijojë një mjedis të përshtatshëm dhe komod për të patur klientë besnik në ndërmarrje.
- të përdorë teknologjinë digjitale gjatë pritjes dhe informimit të klientëve potencialë;
- të kryejë një preventiv të kostove të mundshme, për proceset që do të mund të mund të kryen;

- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë pritjes dhe informimit të klientëve potencialë;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë pritjes dhe informimit të klientëve potencialë.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 3 Nxënësi nxit dhe bind klientët për të kryer blerjen.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të udhëheqë drejt biseda të përditshme tregtare në njësitë e shitjes pa parapërgatitje;
- të udhëheqë nëmënyrën e parapërgatitur biseda tregtare me klientë të pritshëm;
- të informojë klientët në mënyrë të saktë dhe të plotë me karakteristikat e produkteve dhe përparësitë e tyre;
- të përdorë me efektivitet teknika të ndryshme argumentimi;
- të nxisë klientin me anë të ofertave speciale ose me anë të përdorimit të nxitësve të tjerë të shitjes, pa ushtruar presion mbi të;
- të përshtatet si duhet ndaj reagimit të klientëve;
- të trajtojë me efektivitet kundërshtimet e klientëve, duke përdorur teknikat e duhura;
- të udhëheqë drejt bisedat e shitjes për klientët potencialë me pretendime;
- të kryejë saktë procedurën e përfundimit të shitjeve;
- të kryejë shitje nëpërmjet telefonit;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të realizimit të blerjeve të suksesshme të klientëve;
- të kryejë një preventiv të kostove për procesin e blerjes;
- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë realizimit të blerjeve të suksesshme të klientëve;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë realizimit të blerjeve të suksesshme të klientëve.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.**
- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e zyrave mësimore.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për të shpjeguar veprimet që duhet të ndërmerren gjatë komunikimit në raport me klientët.

| | |
|---|---|
| | - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për të shfaqur aftësitë e tyre për mënyrën e sjelljes në vendin e punës, ndaj klientëve dhe bashkëpunëtorëve.<br>- Mund të përdoret loja me role, ku një nxënës të luaj rolin e klientit dhe tjetri rolin e ofruesit të produkteve ose shërbimeve, duke krijuar situata të ndryshme problemore dhe duke i zgjidhur ato.<br>- Gjatë vlerësimit të nxënësve, të zbatohet demonstrimi praktik i aftësive të fituara.<br>- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.<br>- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet plotësimi nga nxënësi i të gjitha kritereve të realizimit të çdo rezultati mësimor të modulit. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:<br>- Zyra mësimore.<br>- Mjete të ndryshme kancelarie.<br>- Mjete demonstruese si pamje filmike, reklama produktesh dhe firmash, etj,. |

## 7. Moduli "Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit gjatë modelimit të veshjeve"

**Kualifikimi: Modelim**
**Niveli: III i KSHK**
**Klasa: 12**

*PËRSHKRUESI I MODULIT*

| | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe Kodi** | **SIGURIA NË PUNË DHE MBROJTJA E MJEDISIT GJATË MODELIMIT TË VESHJEVE** | **M-05-2161-25** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul teoriko-praktik, që i informon dhe i aftëson nxënësit në zbatimin e normave të standardeve të cilësisë, sigurisë në punë, rregullave të garantimit të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë kryerjes së detyrave specifike në mjedisin e punës. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 34 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, të kualifikimit profesional "Tekstil – Konfeksion". | |
| **Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit** | **RN 1** | **Nxënësi zbaton normat e garantimit të cilësisë dhe të sigurisë gjatë veprimeve në ambientin e punës.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>- të shpjegojë rëndësinë dhe përparësitë e normave dhe standardeve të cilësisë në mjedisin e punës;<br>- të përshkruajë normat themelore të garantimit të cilësisë mjedisin e punës;<br>- të përshkruajë sistemet garantimit të cilësisë gjatë veprimtarive në mjedisin e punës;<br>- të tregojë rëndësinë e dokumentacionit që përdoret në sistemet e cilësisë të ambjentit;<br>- të përshkruajë dhe ilustrojë rregullat dhe masat që duhen marrë në një mjedis pune.<br>- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të garantimit të cilësisë dhe të sigurisë në mjediset e punës;<br>- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë garantimit të cilësisë dhe të sigurisë në mjediset e punës;<br>- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë garantimit të cilësisë dhe të sigurisë në mjediset e punës.<br>-<br>***Instrumentet e vlerësimit:*** |

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 2 Nxënësi zbaton rregullat e sigurisë për shmangien e rreziqeve në mjedisin e punës.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë rreziqet dhe shkaqet e rreziqeve gjatë punës në laborator.
- të zbatojë rregullat dhe standardet e sigurisë në laborator.
- të përshkruajë mjediset e laboratorit dhe rreziqet përkatëse.
- të përshkruajë rreziqet mekanike, fizike,kimike, biologjike, ergonomike dhe psikologjike, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre.
- të japë ndihmën e parë në rast aksidenti sipas procedurës;
- të zbatojë planin e evakuimit në raste emergjence sipas procedurës respektive;
- të zbatojë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit sipas rregullores përkatëse;
- të zbatojë masat përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike;
- të zbatojë mënyrat e ndryshme të riciklimit të mbetjeve teknologjike;
- të zbatojë protokollet e duhura në raste pandemie;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të zbatimit të rregullave të sigurisë për shmangien e rreziqeve të mundshme në mjedisin e punës;
- të kryejë një preventiv të kostove për zbatimin e rregullave të sigurisë për shmangien e rreziqeve të mundshme në mjedisin e punës;
- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë shmangies së rreziqeve të mundshme në mjedisin e punës;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë zbatimit të rregullave të sigurisë për shmangien e rreziqeve të mundshme në mjedisin e punës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

| | |
|---|---|
| **Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.** | - Ky modul duhet të zhvillohet në mjediset e:<br>- Laboratorit të projektimit dhe prodhimit të veshjeve<br>- Laboratorit fiziko<br>- mekanik kimik të tekstilit<br>- Laboratorit fiziko - kimik të tekstilit. |

| | |
|---|---|
| | - Mësuesi duhet të japë sa më shumë shembuj dhe ilustrime të koncepteve dhe parametrave të cilësisë, saktësisë dhe sigurisë si dhe të demonstrojë procedura laboratorike në përputhje me këto norma e standarde.<br>- Nxënësi duhet të angazhohet sa më shumë të jetë e mundur në diskutimet në lidhje me konceptet dhe parametrat e sigurisë, saktësisë dhe cilësisë, me normat dhe standardet përkatëse si dhe të kryejnë procedura laboratorike në përputhje me këto norma e standarde.<br>- Gjatë vlerësimit të Nxënësit duhet të synohet më tepër në verifikimin e shkallës së aftësive praktike që ata kanë fituar për të kryer veprime dhe organizimin efektiv gjatë veprimtarisë në laborator.<br>- Mësuesi duhet të kërkojë me rreptësi zbatimin e normave dhe standardeve të cilësisë dhe të sigurisë.<br>- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet plotësimi nga nxënësi i të gjitha kritereve të realizimit të çdo rezultati mësimor të modulit. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin e mësimit, të pasjisur si më poshtë:<br>- Laborator fiziko- mekanik dhe kimik i tekstilit.<br>- Laborator i projektimi dhe prodhimit të veshjeve<br>- Tabela dhe pankarta ilustruese.<br>- Pajisje dhe mjete laboratorike.<br>- Reagentë kimikë dhe materiale të tjera laboratorike.<br>- Dokumente të normave dhe standardeve për veprimet laboratorike.<br>- Rregullore të cilësisë dhe sigurisë në laboratoret fiziko – mekanik dhe kimik.<br>- Manuale, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul. |

## X. Përshkruesit e moduleve me zgjedhje të detyruar të praktikës profesionale

### 1. Moduli "Realizimi dhe konfeksionimi i prototipit të veshjeve të brendshme"

**Kualifikimi: Modelim**
**Niveli: III i KSHK**
**Klasa: 12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe Kodi** | **REALIZIMI DHE KONFEKSIONIMI I PROTOTIPIT TË VESHJEVE TË BRENDSHME** | **M-33-2162-25** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që aftëson nxënësit për të realizuar procese të ndryshme të prerjes dhe qepjes së veshjeve të brendshme për meshkuj dhe femra. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 102 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, të kualifikimit profesional "Tekstil – Konfeksion". | |
| **Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit** | **RN 1** **Nxënësi ndërton kallëpet e veshjeve të brendshme për femra dhe meshkuj.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për ndërtimin e kallëpeve të veshjeve të brendshme të modeluara për femra dhe meshuj.<br>- të nxjerrë masat nga tabela e përmasave.<br>- të llogarisë koefiçentin e elasticitetit kur veshja e brendshme do të bëhet prej trikotazhi.<br>- të përzgjedhë materialet kryesore dhe ndihmëse.<br>- të përzgjedhë aksesorë të ndryshëm, që ndihmojnë në skicimin e veshjeve të brendshme<br>- të skicojë bluzat T-shirt për femra e meshkuj.<br>- të skicojë kanatjeret për femra dhe meshkuj;<br>- të skicojë mbathjet për femra dhe meshkuj<br>- të skicojëë recipetat për femra;<br>- të skicojë veshjet e gjumit;<br>- të kontrollojë skicat përkatëse të prerjes;<br>- të presë kallëpet përkatëse;<br>- të vendosë shenjat përkatëse të refermit;<br>- të përdorë teknologjinë digjitale gjatë ndërtimit të kallëpeve të veshjeve të brendshme; | |

- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë ndërtimit të kallëpeve të veshjeve të brendshme;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë ndërtimit të kallëpeve të veshjeve të brendshme.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 2 Nxënësi pret veshjet e gjumit për femra e meshkuj.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës për prerjen e objektit;
- të përgatisë mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet dhe aksesoret;
- të shtrojë pëlhurën në tavolinën e prerjes;
- të vendosë kallëpet mbi pëlhurë;
- të kryejë shënimin e vijave të prerjes mbi pëlhurë;
- të presë pjesët e sipërme në pëlhurë;
- të presë pjesët e poshtme në pëlhurë;
- të vendosë shenjat e referimit;
- të përdorë teknologjinë digjitale, gjatë prerjes së veshjeve të gjumit;
- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë prerjes së veshjeve të gjumit;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë prerjes së veshjeve të gjumit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 3 Nxënësi qep veshjen e sipërme të rrobave të gjumi për femra e meshkuj.**

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përgatisë filetot veref për kanatjeren;
- të vendosë tantellën në pjesën e gjoksit;
- të qepë fileton në pjesën e përparme dhe të shpinës së kanatjeres;
- të qepë harkun e mëngëve me fileto;
- të qepë rripin me fileto;
- të qepë shpinën me përparësen e kanatjerres;
- të hekurosë veshjen e përfunduar;

- të përdorë teknologjinë digjitale, gjatë qepjes së veshjes së sipërme të rrobave të gjumit;
- të kryejë një llogaritje të kostove të veshjes së sipërme të qepur;
- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë qepjes së veshjes së sipërme të rrobave të gjumit;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë qepjes së veshjes së sipërme të rrobave të gjumit.

**Instrumentet e vlerësimit:**
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 4 Nxënësi qep veshjen e poshtme të rrobave të gjumit për femra e meshkuj.**

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepjen e objektit me material trikotazhi;
- të qepë shpinën me përparësen në pjesën anësore;
- të qepë fileton në pjesën fundore;
- të bashkojë kavallon;
- të vendosjë llastikun;
- të vendosë rripin;
- të hekurosë veshjen e poshtme;
- të përdorë teknologjinë digjitale, gjatë qepjes së veshjes së poshtme të rrobave të gjumit;
- të kryejë një llogaritje të kostove të veshjes së poshtme të qepur;
- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë qepjes së veshjes së poshtme të rrobave të gjumit;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve, gjatë qepjes së veshjes së poshtme të rrobave të gjumit.

**Instrumentet e vlerësimit:**
- Vëzhgim me listë kontrolli.

| | |
|---|---|
| **Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.** | - Ky modul duhet të trajtohet në repartin e rrobaqepësisë si dhe në ndërmarrje të konfeksonimit.<br>- Mesimëdhënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demostrime konkrete për për prerjen e mbathjeve, kanatiereve, bluzave T-Shirt për femra dhe meshkuj, reçipetave dhe rrobave të gjumit për femra, si dhe qepjen e rrobave të gjumit për meshkuj. |

| | |
|---|---|
| | - Nxënësi duhet të angazhohet në punë konkrete për ndërtimin e kallëpeve të veshjeve të brendshme për pëlhura të endura dhe te trikotuara, për prerjen dhe qepjen e rrobave të gjumit për femra.<br>- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet vlerësimi mbi bazën e demostrimit praktik dhe njohurive që ata kanë marrë.<br>- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet plotësimi nga nxënësi i të gjitha kritereve të realizimit të çdo rezultati mësimor të modulit. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pasijet dhe materialet e mëposhtme:<br>- Repart rrobaqepsie.<br>- Lloje të ndryshme të teksileve prej trikotazhi.<br>- Kompleti i veglave dhe i materialeve për modelimin, prerjen dhe qepjen e objekteve prej trikotazhi<br>- Udhëzues, rregullore për kushtet teknike për modelimin, prerjen dhe qepjen e objekteve me material trikotazhi. |

**2. Moduli “Zhvillimi i kallëpeve në masa të tjera”**

**Kualifikimi: Modelim**
**Niveli: III i KSHK**
**Klasa: 12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe Kodi** | **ZHVILLIMI I KALLËPEVE NË MASA TË TJERA** | **M-33-2163-25** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që aftëson nxënësit për të njohur ngjyrat, harmoninë, sfumaturat, kontrastet dhe raportet e ngjyrave përmes realizimit të një natyre të qetë, peisazh etj. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 51 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, të kualifikimit profesional “Tekstil – Konfeksion”. | |
| **Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit** | **RN 1** | **Nxënësi realizon zhvillimin e masave të kallëpeve të fundeve.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për realizimin e gradimit manual të fundit;<br>- të përshkruajë mënyrat e gradimit manual të kallëpeve të fundit;<br>- të ndërtojë boshtin koordinativ të zhvillimit të masave;<br>- të evidentojë linjat e pandryshueshme në kallëpin e fundit;<br>- të përshkruaj rëndësinë e pikave antropometrike ku do të kryhet zmadhimi/zvogëlimi i kallëpit të fundit;<br>- të pëcaktojë masën e ndryshimit ne centimetra/milimetra të kallëpit në bazë të tabelës së përmasave;<br>- të evidentojë pikat e ndryshimit në gjatësi të kallëpit të fundit;<br>- të evidentojë pikat e ndryshimit në gjerësi të kallëpit të fundit;<br>- të evidentojë pikat e ndryshimit të shenjave orientuese;<br>- të kryejë gradimin manual të fundit të thjeshtë;<br>- të kryejë gradimin manual të fundit veref;<br>- të kryejë gradimin manual të fundeve të modeluara;<br>- të përdorë teknologjinë digjitale për realizimin e zhvillimit të masave të kallëpeve të fundit;<br>- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit |

teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë realizimit të zhvillimit të masave të kallëpeve të fundit;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë realizimit të zhvillimit të masave të kallëpeve të fundit.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 2 Nxënësi realizon zhvillimin e masave të kallëpeve të bluzave.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për realizimin e gradimit manual të bluzave;
- të përshkruajë mënyrat e gradimit manual të kallëpeve të bluzave;
- të ndërtojë boshtin koordinativ të zhvillimit të masave;
- të evidentojë linjat e pandryshueshme në kallëpin e bluzave;
- të përshkruaj rëndësinë e pikave antropometrike ku do të kryhet zmadhimi/zvogëlimi i kallëpit të bluzave;
- të pëcaktojë masën e ndryshimit ne centimetra/milimetra të kallëpit në bazë të tabelës së përmasave;
- të evidentojë pikat e ndryshimit në gjatësi të kallëpit të bluzave;
- të evidentojë pikat e ndryshimit në gjerësi të kallëpit të bluzave;
- të evidentojë pikat e ndryshimit të shenjave orientuese;
- të kryejë gradimin manual të bluzës së thjeshtë pa pencë;
- të kryejë gradimin manual të bluzës së thjeshtë me pencë;
- të kryejë gradimin manual të bluzave të modeluara;
- të kryejë gradimin manual të mëngës së bluzës;
- të kryejë gradimin manual të këmishës;
- të kryejë gradimin manual të mëngës së këmishës;
- të kryejë gradimin manual të jakave të ndryshme;
- të përdorë teknologjinë digjitale për realizimin e zhvillimit të masave të kallëpeve të bluzave;
- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë realizimit të zhvillimit të masave të kallëpeve të bluzave;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë realizimit të zhvillimit të masave të kallëpeve të bluzave.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

| | | |
|---|---|---|
| | **RN 3** | **Nxënësi realizon zhvillimin e masave të kallëpeve të pantallonave.**<br>**Kriteret e vlerësimit:**<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për realizimin e gradimit manual të pantallonave;<br>- të përshkruajë mënyrat e gradimit manual të kallëpeve të pantallonave;<br>- të ndërtojë boshtin koordinativ të zhvillimit të masave;<br>- të evidentojë linjat e pandryshueshme në kallëpin e pantallonave;<br>- të përshkruaj rëndësinë e pikave antropometrike ku do të kryhet zmadhimi/zvogëlimi i kallëpit të pantallonave;<br>- të pëcaktojë masën e ndryshimit ne centimetra/milimetra të kallëpit në bazë të tabelës së përmasave;<br>- të evidentojë pikat e ndryshimit në gjatësi të kallëpit të pantallonave;<br>- të evidentojë pikat e ndryshimit në gjerësi të kallëpit të pantallonave;<br>- të evidentojë pikat e ndryshimit të shenjave orientuese;<br>- të kryejë gradimin manual të pantallonit të thjeshtë;<br>- të kryejë gradimin manual të pantallonave të modeluara;<br>- të përdorë teknologjinë digjitale për realizimin e zhvillimit të masave të kallëpeve të pantallonave;<br>- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë realizimit të zhvillimit të masave të kallëpeve të pantallonave;<br>- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë realizimit të zhvillimit të masave të kallëpeve të pantallonave.<br>**Instrumentet e vlerësimit:**<br>- Vëzhgim me listë kontrolli. |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.** | | - Ky modul duhet të trajtohet në klasën/laboratorin e prerjes Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë që është e mundur demonstrimet konkrete të zmadhimit dhe të zvogëlimit të pjesëve të ndryshme të veshjeve.<br>- Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për realizimin e gradimit të veshjeve.<br>- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të zbatohet vlerësimi mbi bazën e demostrimit praktik të aftësive dhe njohurive të fituara.<br>- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet plotësimi nga nxënësi i të gjitha kritereve të realizimit të çdo rezultati mësimor të modulit. |
| **Kushtet e** | | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të |

| | |
|---|---|
| **e domosdoshme për realizimin e modulit** | sigurohen mjediset, mjetet dhe materialet e mëposhtme:<br>- Tabak letre, tabela ose letra milimetrike, laps, vizore, kurbalinja, vizore këndëdrejtë.<br>- Tavolina të përshtatëshme për për zhvillimin e masave të veshjeve.<br>- Udhëzues, rregullore për kushtet teknike për zhvillimin e masave. |

## 3. Moduli "Projektimi modeleve të veshjeve me anë të CAD/CAM"

**Drejtimi: Tekstil-Konfeksione**
**Profili: Modelim**
**Niveli: III i KSHK**
**Klasa: 12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe Kodi** | **PROJEKTIMI MODELEVE TË VESHJEVE ME ANË TË CAD/CAM** | **M-33-1688-20** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që aftëson nxënësit për të ndërtuar skicën teknike të veshjeve duke përdorur programe të caktuara kompjuterike, si CAD/CAM. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 51 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK, të kualifikimit profesional "Tekstil – Konfeksion". | |
| **Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit** | **RN 1** | **Nxënësi ndërton skicën teknike të fundit të thjeshtë, për femra, me anë të programit CAD/CAM.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për përdorimin e programit;<br>- të hapë dritaren e punës;<br>- të emërtojë objektin e përzgjedhur;<br>- të vendosë masat bazë të fundit<br>- të ndërtojë skicën teknike të fundit të thjeshtë duke u mbështetur në rrjetën bazë të linjave;<br>- të caktojë pozicionin e pikave kostruktive të vizatimit<br>- të ndërtojë kurbat<br>- të ndërtojë pensat për shpinën dhe përparësen duke përdorur komandat e programit;<br>- të përcaktojë pikat e vendosjes së xhepit oblik;<br>- të ndërtojë skicën teknike të qemerit;<br>- të përcaktojë pikat ku do të vendosen cikatjet;<br>- të ruajë materialin në kompjuter;<br>- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë ndërtimit të skicës teknike të fundit të thjeshtë, për femra, me anë të programit CAD/CAM. |

- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë ndërtimit të skicës teknike të fundit të thjeshtë, për femra, me anë të programit CAD/CAM.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 2 Nxënësi ndërton skicën teknike të bluzës së thjeshtë, për femra dhe meshkuj, me anë të programit CAD/CAM.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për përdorimin e programit;
- të hap dritaren e punës;
- të emërtojë objektin e përzgjedhur;
- të vendosen masat bazë të bluzës;
- të ndërtojë skicën teknike të bluzës të thjeshtë (shpinë, përparëse) duke u mbështetur në rrjetën bazë të linjave;
- të ndërtojë skicën teknike të mëngës duke u mbështetur në rrjetën bazë të linjave;
- të caktojë pozicionin e pikave kostruktive të vizatimit
- të ndërtojë kurbat;
- të ndërtojë pensat duke përdorur komandat e programit;
- të përcaktojë pikat ku do të vendosen cikatjet;
- të ruajë materialin në kompjuter;
- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë ndërtimit të skicës teknike të bluzës së thjeshtë, për femra dhe meshkuj, me anë të programit CAD/CAM;
- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë ndërtimit të skicës teknike të bluzës së thjeshtë, për femra dhe meshkuj, me anë të programit CAD/CAM.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 3 Nxënësi ndërton skicën teknike të pantallonit të thjeshtë, për femra dhe meshkuj, me anë të programit CAD/CAM.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për përdorimin e programit;
- të hap dritaren e punës;
- të emërtojë objektin e përzgjedhur;
- të vendosen masat bazë të pantallonit;

| | |
|---|---|
| | - të ndërtojë skicën teknike të pantallonit të thjeshtë(femra, meshkuj) duke u mbështetur në rrjetën bazë të linjave;<br>- të caktojë pozicionin e pikave kostruktive të vizatimit;<br>- të ndërtojë kurbat;<br>- të ndërtojë pensat për shpinën dhe përparësen duke përdorur komandat e programit;<br>- të përcaktojë pikat e vendosjes së xhepit oblik;<br>- të ndërtojë skicën teknike të qemerit;<br>- të përcaktojë pikat ku do të vendosen cikatjet;<br>- të ruajë materialin në kompjuter;<br>- të zbatojë rregullat higjieno-sanitare, ato të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë ndërtimit të skicës teknike të pantallonit të thjeshtë, për femra dhe meshkuj, me anë të programit CAD/CAM;<br>- të zbatojë rregullat për optimizimin e përdorimit të energjisë, ujit, materialeve gjatë ndërtimit të skicës teknike të pantallonit të thjeshtë, për femra dhe meshkuj, me anë të programit CAD/CAM.<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>- Vëzhgim me listë kontrolli. |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.** | - Ky modul duhet të trajtohet në klasën/ laboratorin e CAD/CAM.<br>- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë që është e mundur demonstrimet konkrete të përdorimit të komandave të programit për projektimin e modeleve të veshjeve.<br>- Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për realizimin e objekteve te modeluara nëpërmjet programeve të CAD-it.<br>- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të zbatohet vlerësimi mbi bazën e demostrimit praktik të aftësive dhe njohurive të fituara.<br>- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet plotësimi nga nxënësi i të gjitha kritereve të realizimit të çdo rezultati mësimor të modulit. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, mjetet dhe materialet e mëposhtme:<br>- Kompjutera të pajisura me programet përkatëse funksionale.<br>- Tavolina te përshtatëshme, stola , programet e licensuara, internet.<br>- Udhëzues, rregullore për kushtet teknike gjatë punës me programin e CAD-it. |

## 4. Moduli “Shoqëria e nxënësve”

**Kualifikimi:** **Modelim**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12të**

Hartuar në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, “Për zbatimin e moduleve lëndorë Junior Achievement of Albania”.

*PËRSHKRUESI I MODULIT*

| | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **SHOQËRIA E NXËNËSVE** | **M-17-2199-25** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të krijuar një shoqëri/ kompani biznesi, për të: kryer procedurat e zgjedhjeve për drejtues e personel, analizuar produktin, kryer proceset e shitjes dhe blerjes, për të promovuar produktin e shoqërisë/ kompanisë, si dhe për të kryer regjistrime të thjeshta dhe përgatitjen e raportit përfundimtar. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 51 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar klasën e 11të, niveli II i KSHK, në kualifikimin profesional “Tekstil konfeksione”. | |
| **Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit** | **RN 1** **Nxënësi krijon shoqëri/ kompani.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>- të kryejë studimin fillestar të tregut për krijimin e një shoqërie/ kompanie;<br>- të përcaktojë qartë qëllimin e veprimtarisë së shoqërisë/ kompanisë;<br>- të përcaktojë qartë llojin e biznesit (tregti, prodhim, shërbim etj.), si dhe fushën ekonomike në të cilën do të zhvillohet veprimtaria;<br>- të vendosë emrin e shoqërisë/ kompanisë, duke pasur parasysh veprimtarinë dhe qëllimin e saj;<br>- të përcaktojë qartë misionin dhe vizionin në lidhje me veprimtarinë dhe identitetin e shoqërisë/ kompanisë;<br>- të përzgjedhë formën juridike më të përshtatshme, në varësi të mundësive të financimit dhe kërkesave të pronarëve;<br>- të hartojë dokumentet themelorë juridik (statuti/ rregullore ose akt themelimi); | |

- të regjistrojë shoqërinë/ kompaninë në Qendrën Kombëtare të Bizneseve (QKB);

***Instrumentet e vlerësimit***:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 2 Nxënësi kryen procedurat e zgjedhjeve për drejtues dhe personel.**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të planifikojë një proces zgjedhor/ rekrutimi transparent (kandidatët, mënyrën e votimit, afatet, rregullat etj.);
- të ndjekë një rend dhe strukturë të caktuar në organizimin e votimeve (në asamblenë e aksionerëve);
- të hartojë një rregullore të qartë dhe të thjeshtë për funksionimin e departamenteve të shoqërisë/ kompanisë;
- të prezantojë rregullat për zgjedhjen në departamente;
- të prezantojë rolet që duhet të mbulojnë kandidatët e propozuar, sipas departamenteve;
- të respektojë mendimin e shumicës dhe kur ai nuk përputhet me preferencat personale;
- të zgjedhë personin e duhur për drejtues / personel, sipas aftësive për rolin;
- të vlerësojë cilësitë e liderit (motivimin, përgjegjshmërinë, korrektësinë, përkushtim etj.);
- të përdorë mënyra të ndryshme ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- të kontribuojë për një atmosferë bashkëpunuese, gjatë procesit zgjedhor;
- të pranojë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për drejtues dhe personel.

***Instrumentet e vlerësimit***:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 3 Nxënësi analizon produktin e përzgjedhur objekt i veprimtarisë së shoqërisë/ kompanisë.**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë qëllimin kryesor dhe dytësorë të studimit të tregut;
- të përcaktojë objektivat e studimit të tregut;
- të përcaktojë metodën bazë për studimin e tregut;
- të krijojë grupin e punës për studimin e tregut dhe të ndajë detyrat në grup;

- të përzgjedhë metodat kryesore dhe burimet e mbledhjes së të dhënave (intervista, pyetësorë, hulumtim on-line etj.);
- të përgatitë pyetësorët për mbledhjen e të dhënave të tregut;
- të realizojë me kujdes dhe saktësi intervistimet në funksion të objektit të studimit të tregut;
- të kryejë përpunimin paraprak të të dhënave, duke i seleksionuar ato;
- të kryejë përpunimin statistikor dhe analizën përmbajtësore të të dhënave;
- të përgatitë rezultatet e studimit të tregut (gjetjet dhe propozimet);
- të hartojë planin e biznesit duke:
  - prezantuar qartë idenë dhe përshkruar në mënyrë të detajuar sipërmarrjen;
  - përshkruar qartë prodhimin/ tregtimin;
  - përcaktuar karakteristikat që dallojnë ofertën e shoqërisë/ kompanisë së tij nga ajo e konkurrentëve;
  - përcaktuar vendndodhjen, ku do të zhvillojë aktivitetin biznesi i saj;
  - përcaktuar politikat që ndiqen për produktin apo shërbimin;
  - pasqyruar tabelat për shpenzimet e parashikuara dhe të ardhurat e pritshme;
  - përcaktuar burimet financiare që nevojiten për të kryer investimet fillestare;
  - përshkruar se si do të organizohet biznesi, duke specifikuar numrin e të punësuarve, llojin e kontratave dhe kostot relative;
- të kontrollojë përfundimisht strukturën dhe korrektësinë e përmbajtjes së planit të biznesit;
- të vlerësojë cilësinë, dobishmërinë dhe përputhjen e produktit me nevojat e tregut;
- të vlerësojë përfitimet dhe kufizimet e produktit;
- të vlerësojë mendimet e përdoruesve/ testuesve të produkteve;
- të përmirësojë vazhdimisht produktin, sipas analizimeve të bëra.

***Instrumentet e vlerësimit***:
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 4 Nxënësi kryen proceset e blerjes/ shitjes.**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë nevojat për blerje për fillimin e aktivitetit;
- të evidentojë furnitorët potencialë në fushën e biznesit;
- të analizojë furnitorët ekzistues;
- të kontaktojë furnitorët potencialë dhe të sigurojë informacione për ta;
- të zbatojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal, gjatë komunikimit me furnitorët;
- të kërkojë oferta e lista çmimesh për artikuj;
- të krahasojë ofertat e furnitorëve potencialë dhe të evidentojë ofertën më të përshtatshme për biznesin;
- të hartojë planin e blerjes dhe të ndjekë realizimin e tij;
- të ndjekë hapat e duhura, gjatë procesit të blerjes;
- të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm që përdoret, gjatë procesit të blerjes;
- të kërkojë me kujdes informacione për klientët potencialë;
- të përpunojë kërkesat e klientëve;
- të hartojë listat e çmimeve për klientët;
- të hartojë oferta të ndryshme;
- të pranojë, kontrollojë dhe regjistrojë saktë, porositë e mbërritura nga klientët;
- të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm, gjatë procesit të shitjes;
- të kryejë kontrollin e gjendjes fizike të produkteve për shitje;
- të përgatitë produktin për shpërndarje;
- të ambalazhojë produktin, sipas rastit;
- të përzgjedhë kushtet e lëvrimit dhe pagesës që i përshtaten më mirë shoqërisë/ kompanisë, qëllimeve dhe kushteve të veprimtarisë së saj;
- të hartojë saktë faturat e shitjes së mallrave;
- të hartojë refuzimet e shitjeve për arsye dhe në situata të ndryshme;
- të zgjidhë situatat në raste ankesash nga klientët;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit, gjatë blerjes/ shitjes.

***Instrumentet e vlerësimit***:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 5 Nxënësi kryen promovimin e produktit të shoqërisë/ kompanisë.**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë produktin të cilit do t`i bëhet marketingu;
- të identifikojë lloje të ndryshme të platformave digjitale dhe mediave sociale;
- të analizojë kriteret për përzgjedhjen e platformës digjitale dhe medias sociale;
- të përzgjedhë platformën digjitale dhe median sociale;
- të prezantojë platformën digjitale dhe median sociale të përzgjedhur;
- të përgatitë materiale të ndryshme interaktive (tekst, imazh, video etj.);
- të hartojë fletëpalosje dhe materiale të tjera reklamuese dhe informuese;
- të hartojë kartëvizitat e materiale të tjera informative për shoqërinë/ kompaninë dhe personelin e saj;
- të ndërtojë video, duke përdorur programe (software) të ndryshme (Movie maker ose nëpërmjet aparatit celular, smartphone etj.);
- të modifikojë imazhe të ndryshme me software (photoshop, canva etj.);
- të ngarkojë (publikojë) materialet e mësipërme në platformën digjitale dhe median sociale të përzgjedhur;
- të përgatitë një plan orar, ditor dhe javor në lidhje me promovimin e produkteve të shoqërisë/ kompanisë;
- të krijojë fushata marketingu, duke përdorur burime të ndryshme reklamimi (rrjetet sociale, e-mail ose mobile marketing);
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm, gjatë promovimit të produktit.

***Instrumentet e vlerësimit***:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RN 6 Nxënësi harton dhe analizon raportin vjetor.**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të hartojë një pasqyrë të thjeshtë financiare të mjeteve, detyrimeve dhe kapitalit të vetë shoqërisë/ kompanisë;
- të evidentojë saktë se cilët dokumente do të përdoren për regjistrimin dhe pasqyrimin e veprimtarisë;
- të hartojë saktë dokumentet që mund të përdoren në shoqëri/ kompani (ditarin, librin e arkës, libër i magazinës etj.);

| | |
|---|---|
| | - të regjistrojë gjendjen në dokumentet financiare përkatës;<br>- të regjistrojë saktë derdhjet e aksionerëve në para dhe në natyrë, sipas llojeve;<br>- të regjistrojë saktë derdhjet e kapitalit të nënshkruar në fillim dhe gjatë veprimtarisë së shoqërisë/ kompanisë;<br>- të regjistrojë saktë shumat e shpenzimeve të paguara paraprakisht për krijimin, regjistrimin, asistencën ligjore, si dhe për zgjerimin e veprimtarisë ose ndryshimin e formës juridike;<br>- të regjistrojë blerjet dhe shitjet e kryera;<br>- të regjistrojë saktë shpenzimet e punës, detyrimet ndaj personelit, sigurimeve dhe shtetit për TAP, duke u bazuar në listëpagesën e pagave;<br>- të deklarojë në afatin e duhur detyrimet ndaj shtetit;<br>- të kryejë saktë mbylljen e llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve;<br>- të evidentojë rezultatin ekonomik të shoqërisë/ kompanisë;<br>- të prezantojë rezultatin përfundimtar të shoqërisë/ kompanisë;<br>- të marrë vendim për shpërndarjen e dividentit, bazuar në përqindjen të aksioneve;<br>- të kryejë veprimet për likuidimin përfundimtar të shoqërisë/ kompanisë.<br>***Instrumentet e vlerësimit***:<br>- Vëzhgim me listë kontrolli. |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.** | - Ky modul duhet të trajtohet në shkollë/ klasë dhe në biznes.<br>- Mësimdhënësi duhet të kryejë demonstrime konkrete lidhur me hapat që ndiqen për: krijimin e një shoqërie/ kompanie biznesi, zbatimin e procedurave të zgjedhjeve për drejtues e personel, analizimin e produktit, realizimin e proceseve të shitjes dhe blerjes, promovimin e produktit të shoqërisë/ kompanisë, si dhe për të kryer regjistrime të thjeshta dhe përgatitjen e raportit përfundimtar.<br>- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë lidhur me krijimin e një shoqërie/ kompanie biznesi, zbatimin e procedurave të zgjedhjeve për drejtues e personel, analizimin e produktit, realizimin e proceseve të shitjes dhe të blerjes, promovimin e produktit të shoqërisë/ kompanisë, si dhe për të kryer regjistrime të thjeshta dhe përgatitjes së raportit përfundimtar.<br>- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet t’i vihet theksi verifikimit të shkallës së arritjeve të shprehive praktike për krijimin e një |

| | |
|---|---|
| | shoqërie/ kompanie biznesi, zbatimin e procedurave të zgjedhjeve për drejtues e personel, analizimin e produktit, realizimin e proceseve të shitjes dhe të blerjes, promovimin e produktit të shoqërisë/ kompanisë, si dhe për të kryer regjistrime të thjeshta dhe përgatitjes së raportit përfundimtar.<br>- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizmit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:<br>- Udhëzuesi i mësuesit.<br>- Udhëzuesi i nxënësit.<br>- Model statuti dhe akt themelimi.<br>- Modele pasqyrash financiare.<br>- Model letra me vlerë/ aksione.<br>- Libër i arkës.<br>- Libër/ kartela magazine.<br>- Model pyetësori.<br>- Formularë të porosive të shitjeve.<br>- Formularë raportimi.<br>- Materiale kancelarie.<br>- Certifikatat e arritjeve.<br>- Kompjuter/ Lap top.<br>- Projektor.<br>- Internet.<br>- USB dhe CD. |

## XI. Program orientues për provimet përfundimtare, të Kualifikimit Profesional “Modelim” Niveli III i KSHK.

### A) Programi orientues për Provimin e Teorisë Profesionale të Integruar

**Programi orientues** për provimin e teorisë profesionale të integruar, në kualifikimin **“Modelim**”, **Niveli III i KSHK,** është hartuar duke u mbështetur në temat më të rëndësishme të programeve të lëndëve profesionale më përfaqësuese dhe më thelbësore, të cilat përbëjnë 30-35 % të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

**Tabela 1: Lëndët profesionale** të përzgjedhura për t`u përfshirë në provimin e teorisë profesionale dhe temat e përzgjedhura në të, janë si më poshtë.

| Nr | Lënda | Vëllimi i orëve për çdo lëndë | Peshat në % |
|---|---|---|---|
| 1 | Moda dhe estetika | **32** | **40** |
| 2 | Modelimi dhe prerja e veshjeve | **46** | **60** |
| | **TOTALI** | **78** | **100** |

**Temat sipas lëndëve janë:**

**a)** Temat nga lënda **“Moda dhe estetika”,** kl.12; **Gjithsej 32 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 3** | Funksioni estetik dhe praktik i veshjes sipas grupmoshave | 6 orë |
| **Tema 4** | Linjat e veshjeve në funksionin estetik dhe praktik të tyre | 6 orë |
| **Tema 8** | Moda gjatë shekullit XX | 8 orë |
| **Tema 9** | Moda gjatë fillimshekullit XXI | 6 orë |
| **Tema 12** | Krijimi i ngjyrave | 6 orë |

**b)** Temat nga lënda **“Modelimi dhe prerja e veshjeve”**, kl.12; **Gjithsej 46 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Modelimi dhe prerja e fundeve për femra | 6 orë |
| **Tema 2** | Modelimi dhe prerja e pantallonave (femra meshkuj) | 8 orë |
| **Tema 3** | Modelimi dhe prerja e bluzave dhe këmishave (femra meshkuj) | 8 orë |
| **Tema 4** | Modelimi dhe prerja e fustaneve | 8 orë |
| **Tema 5** | Modelimi dhe prerja e xhaketave (femra meshkuj) | 12 orë |
| **Tema 8** | Modelimi dhe prerja e veshjeve të brendshme | 4 orë |

**Udhëzime për përgatitjen e testit të provimit të teorisë profesionale:**

Provimi i teorisë profesionale të integruar do të jetë me test me shkrim, i cili zgjat 1.5 (një presje pesë) dhe përgatitet nga Komisioni i Provimit Përfundimtar i kualifikimit profesional të nivelit

përkatës. Në hartimin e testit komisioni duhet të mbajë parasysh rregullat, parimet dhe formatet, për ndërtimin e testit.

Testi duhet të përmbajë **30** njësi testi me një total prej **60** pikë. Nga këto, 20 njësi testi të jenë me zgjedhje të shumëfishtë (4 alternativa) dhe 10 të tjerat të jenë njësi testi me përgjigje të kufizuara/ të mbyllura (me PO/ JO; me e Vërtetë/ e Gabuar; me plotësim të fjalës që mungon; etj.)

**Model i shpërndarjes së pikëve për pyetje të niveleve të ndryshme në test.**

| Niveli I (i ulët) | Niveli II (mesatar) | Niveli III (i lartë) |
|---|---|---|
| Aftësia për të rikujtuar/kuptuar/ identifikuar dhe për të përshkruar... | Aftësia për të zbatuar/argumentuar/ shpjeguar/krahasuar dhe për të analizuar... | Aftësia për të vlerësuar dhe për të nxjerrë përfundime... |

**Ndarja e pikëve sipas peshës së çdo lënde dhe niveleve**

| Nr. | Lënda | Peshat e lëndëve në % | Pikët për çdo lëndë | Ndarja e pikëve sipas niveleve të vështirësisë | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Niveli I 40% e pikëve | Niveli II 40% e pikëve | Niveli III 20% e pikëve |
| 1 | **Moda dhe estetika** | **40** | **24** | **10** | **10** | **4** |
| 2 | **Modelimi dhe prerja e veshjeve** | **60** | **36** | **14** | **14** | **8** |
| | **TOTALI** | **100%** | **60 pikë** | **24 pikë** | **24 pikë** | **12 pikë** |

Përcaktimi i pikëve për çdo njësi testi bëhet duke pasur parasysh tipin e njësisë së testit. Për shembull: njësitë e testit me zgjedhje të shumëfishtë marrin gjithmonë 1 (një) pikë përkundrejt përgjigjes së paracaktuar të saktë; njësitë me përgjigje të hapur marrin aq pikë sa kërkesa kanë brenda tyre (duke mbajtur parasysh edhe argumentimin nga nxënësi); njësitë me përgjigje të kufizuar marrin aq pikë sa gjykohet nga grupi hartues dhe kjo lidhet me kërkesat që parashtrohen në pyetje dhe niveli i vështirësisë.
Së fundi, skema e vendosjes së notës kundrejt pikëve të fituara përcaktohet nga grupi hartues i testit. Në vijim, jepet një model i skemës së vlerësimit me nota:

| Pikët e fituara | Notat |
|---|---|
| **0 - 14** | **4** |

| | |
|---|---|
| **15 - 21** | **5** |
| **22 - 29** | **6** |
| **30 – 36** | **7** |
| **37 - 43** | **8** |
| **44 - 52** | **9** |
| **53 - 60** | **10** |

**B) Programi orientues për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar**

**Programi orientues** për provimin e praktikës profesionale të integruar, në profilin mësimor "Modelim", është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

a) **Lista e kompetencave profesionale** për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit**, detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

| Nr | Kompetencat profesionale | Detyrat e punës | Pikët |
|---|---|---|---|
| 1 | Të ndjekë hapat e punës për realizimin e kallëpit të fustanit, bluzës, xhaketës | **Detyra 1:** Ndërtimi i kallëpit të veshjes | **35** |
| 2. | Të ndjekë hapat e punës për realizimin e prerjes së pjesëve të fustanit, bluzës, xhaketës së modeluar | **Detyra 2:** Shënimi dhe prerja në tekstil i pjesëve të veshjes | **30** |
| 3. | Të realizojë bashkëpunimin e pjesëve të veshjes (fustan, bluzë, xhaketës)<br>Të kryejë proceset përfundimtare të veshjes | **Detyra 3:** Qepja e veshjes dhe kryerja e proceseve përfundimtare | **35** |
| **Shuma** | | | **100** |

b) **Skema e vlerësimit me nota:**

| Pikët e fituara | Notat |
|---|---|
| 0 - 40 | 4 |
| 41 - 50 | 5 |
| 51 - 60 | 6 |

| | |
|---|---|
| 61 - 70 | 7 |
| 71 - 80 | 8 |
| 81 - 90 | 9 |
| 91 - 100 | 10 |

**Shënime:**

- Provimi i Praktikës Profesionale do të realizohet me anën e metodës së vlerësimit të nxënësve me detyra pune (në tabelë tregohen 3 detyrat kryesore të punës). Ai do të realizohet në ambjentet e praktikave të shkollave profesionale për të gjitha ato procese që garantohen plotësisht. Për proceset të tjera që nuk garantohen në shkollë, ato do të kryhen në ndërmarrje apo biznese, që plotësojnë kushtet për realizimin e tyre. Në rast të kundërt, rekomandohen si zgjidhje e vetme përfundimtare programet e virtualizimit dhe simulimit.
- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 orë, në përputhje kjo me Udhëzimin për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP.
- Gjatë kryerjes së detyrave, nxënësit do të vlerësohen edhe për kompetencat kyçe të cilat verifikohen gjatë punimeve përkatëse.
- Për vlerësimin e kompetencave profesionale, duhet të zhvillohet edhe bashkëbisedim profesional ndërmjet komisionit dhe nxënësit, si një element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara.
- Gjatë kryerjes së detyrave, nxënësit do të vlerësohen dhe për zbatimin e Rregullave të Sigurimit Teknik, ruajtjes së mjedisit, standardeve, normave dhe etikës teknike (profesionale).
- Është e rëndësishme, që të përgatitet paraprakisht një material udhëzues, i cili do t'u jepet nxënësve para fillimit të provimit, ku të përcaktohen detyrat që do të kryejnë, mënyrën e vlerësimit të tyre, kohën që do të kenë në dispozicion, etj. Gjithashtu, duhet të përgatiten paraprakisht pyetjet të cilat do t'u bëhen nxënësve gjatë kryerjes së detyrave përkatëse (bashkëbisedimit profesional).
- Gjithashtu, për realizimin e detyrave mund të hartohet një grafik për përcaktimin e kohës së realizimit të secilës detyrë.
- Të tri detyrat e përcaktuara nga komisioni, paraqiten me anë të fletëve të punës (tezave të provimit), të cilat do të përzgjidhen nga nxënësit në mënyrë të rastësishme (duhet të hartohen disa variante për secilën detyrë). Nxënësit do të vlerësohen me anë të "listës së kontrollit", me anë të së cilës verifikohen arritjet e tyre kundrejt "kritereve të vlerësimit".

- Fletët e punës (tezat e provimit), udhëzuesi dhe grafiku i kohës të bashkangjitura janë të detyrueshme t'i jepet çdo nxënësi. Gjithashtu një kopje bashkë me listën e vlerësimit mbahet nga komisioni. Në fund bëhet lidhja e fletës së punës së nxënësit me listën e kontrollit për arsye dokumentimi.

Udhëzime për realizimin **e:**

**Detyrës 1:** "Ndërtimi i kallëpit të veshjes".

Në këtë detyrë, nxënësi punon në mënyrë individuale dhe duhet të ketë në dispozicion mjetet e punës, të tilla si: tavolina e prerjes, letër, metër, vizore, gërshërë, laps, pëlhura, makina qepëse dhe pejra. Përgatitja e vendit të punës dhe e makinerive janë pjesë e rëndësishme e realizimit të detyrës praktike. Mësuesi përgatit tezat e provimit për realizimin e kallëpeve për veshje të ndryshme. Nxënësi nxjerr masat e nevojshme nga tabela e përmasave dhe kryen llogaritjen e tyre për realizimin e kallëpit si dhe realizon kartmodelin e letrës, me të gjitha elementet përbërëse të modelit të dhënë. Mbas përfundimit të detyrës, komisioni bën matjet përkatëse se si është realizuar kjo detyrë. Nxënësi vlerësohet me listë kontrolli dhe listë kriteresh, të cilat hartohen nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajnë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale.

**Detyra 2:** "Shënimi dhe prerja në tekstil i pjesëve të veshjes".

Në këtë detyrë nxënësi punon në mënyrë individuale dhe duhet të ketë në dispozicion mjetet e punës, të tilla si: tavolina e prerjes, letër, metër, vizore, gërshërë, laps, pëlhura, makina qepëse dhe pejra. Përgatitja e vendit të punës dhe e makinerive janë pjesë e rëndësishme e detyrës praktike. Nxnësi llogarit tekstilin e nevojshëm për realizimin e veshjes, kryen palosjen e tekstilit saktë në varësi te modelit, vendos mbi tekstil pjesët e modelit sipas rregullave përkatëse, ekonomizon tekstilin gjatë vendosjes së pjesëve të kartmodelit mbi tekstil, kryen shënimin e pjesëve të kartmodelit në tekstil si dhe cikatjeve dhe tolerancave pë qepje, pret elementët përbërës të veshjes. Më pas nxënësi bashkon pjesët e prera në mënyrën e duhur për të ndërtuar modelin e bluzës së dhënë. Mbas përfundimit të detyrës, komisioni bën matjet përkatëse se si është realizuar kjo detyrë. Nxënësi vlerësohet me listë kontrolli dhe listë kriteresh të cilat hartohen nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajnë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale.

**Detyra 3:** "Qepja e veshjes dhe kryerja e proceseve përfundimtare".

Në këtë detyrë, nxënësi punon në mënyrë individuale dhe duhet të ketë në dispozicion

mjetet e punës, të tilla si: tavolina e prerjes, letër, metër, vizore, gërshërë, laps, pëlhura, makina qepëse dhe pejra. Përgatitja e vendit të punës dhe e makinerive janë pjesë e rëndësishme e realizimit të detyrës praktike. Nxnësi bashkon pjesët e prera në mënyrën e duhur për të ndërtuar modelin e veshjes dhe kryen proceset përfundimtare. Mbas përfundimit të detyrës, komisioni bën matjet përkatëse se si është realizuar kjo detyrë. Nxënësi vlerësohet me liste kontrolli dhe listë kriteresh të cilat hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale.